



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



01 Nr. 09/19
Rahovec, 18.09.2019

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më
26 Shtator 2019 (**E Enjte**) me fillim në orën 10:00, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi i dhe aprovimi Propozim vendimit për Ridestiminin e mjeteve të mbetura nga buxheti i vitit 2019,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për Këmbimin e pronës Komunale me sipërfaqe prej 11000 m²,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për Këmbimin e pronës Komunale me sipërfaqe prej 25099 m²,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Buxhetit si dhe KAB-it për vitin 2020 – 2022,
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit Strategjik Komunal për Kujdesin Parësor Shëndetësor në Rahovec 2020-2024.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



**Plani Strategjik Komunal për Kujdesin Parësor
Shëndetësor në Rahovec**
2020-2024

Gusht 2019

FJALA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Hartimi i këtij Plani Strategjik Komunal për Kujdesin Parësor Shëndetësor në komunën e Rahovecit 2020-2024 shërben si dokument dhe udhërrëfyes i politikave shëndetësore afatgjate. Ky plan do të përdoret për zhvillimin e sistemit shëndetësor në komunën e Rahovecit.

Ofrimi i shërbimeve sa më cilësore të Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe krijimi i kushteve sa më të favorshme për qytetarët e kësaj komune është edhe qëllimi kryesor i këtij dokumenti.

Duke marrë për bazë parimet e Kujdesit Parësor Shëndetësor, ky dokument ka për fokus edhe promovimin e mënyrave të shëndetshme të jetesës së qytetarëve të komunës së Rahovecit, gjithmonë duke shkuar konform karakteristikave demografike të popullatës.

Nevoja për planifikim të mirëfilltë në sektorin e shëndetësisë është identifikuar përmes analizave të situatës. Me zbatimin e këtij plani do të mundësohet edhe arritja e misionit të Kujdesit Parësor Shëndetësor për të ofruar shërbime të cilësisë së lartë, të vazhdueshme, të integruara dhe të qasshme nga i gjithë komuniteti.

Komuna e Rahovecit, gjegjësisht, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, përmes implementimit të këtij Plani Zhvillimor për Kujdesin Parësor Shëndetësor do të përmbushë vizionin e politikave të krijuara. Ky plan do të bazohet në komunitet dhe zbatimi i tij do të shërbejë për trajtimin e problemeve më të përhapura shëndetësore të popullatës duke zhvilluar shërbimet parandaluese, riaftësuese, kurative si dhe të promocionit shëndetësor, gjithmonë duke marrë parasysh parimet bazë të Kujdesit Parësor Shëndetësor për të siguruar qasje të barabartë në shërbime për të gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit.

MIRËNJOHJE

Falënderojmë të gjithë anëtarët e grupit punues për angazhimin e tyre maksimal në hartimin e këtij dokumenti strategjik shumë të rëndësishëm për avancimin e Kujdesit Parësor Shëndetësor në komunën e Rahovecit.

Gjithashtu, shprehim mirënjohjen tonë të thellë për mjekët dhe infermieret e Kujdesit Parësor Shëndetësor të cilët përmes anketës së realizuar nga ekspertët e AQH-së kanë kontribuar në vlerësimin e nevojave shëndetësore të komunitetit.

Dëshirojmë të falënderojmë për zemërsisht edhe të gjithë pjesëmarrësit, në fokus, grupe, përfaqësuesit e institucioneve, OJQ-ve dhe përfaqësuesit e komunitetit të cilët kanë dhënë opinionet e tyre lidhur me nevojat shëndetësore të komunitetit, por edhe i kanë rekomanduar DSHPS aktivitete që duhet të ndërmerren për të adresuar këto nevoja.

Për fund dëshirojmë t'i shprehim mirënjohjen tonë të veçantë ekipit të AQH-së për trajnime, mbështetje dhe mentorim të vashdueshëm përgjatë tërë këtij procesi.

PËRMBAJTJA

FJALA E KRYETARIT TË KOMUNËS.....	2
MIRËNJOHJE	3
SHKURTESAT.....	5
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	6
HYRJE.....	7
METODOLOGJIA.....	8
SFONDI.....	9
Të dhënat sociodemografike	9
ANALIZA E SITUATËS	11
Gjendja shëndetësore e popullatës.....	11
Mjekësia Familjare	12
Njësia e Pedriatise	12
Gjinikologjia dhe Materniteti	13
Njesia e Urologjise	14
Sektori i Stomatologjise.....	14
Ethet hemoragjike – Krime Kongo.....	14
Organizimi i Kujdesit Parësor Shëndetësor	15
Rrjeti i Institucioneve Shendetesore	16
Shërbimet shëndetësore në KPSH.....	19
Burimet njerëzore.....	22
Pajisjet	23
Furnizimi me barna dhe material shpenzues.....	23
Financimi i shërbimeve shëndetësore.....	23
Bashkëpunimi me sektorët tjerë	24
Sektori shëndetësor privat.....	25
Cilësia e kujdesit shëndetësor	25
Infrastruktura.....	25
Proceset – Observimet klinike.....	26
Kënaqshmëria për shërbimet shëndetësore	26
Vlerësimi i nevojave shëndetësore të komunitetit.....	26
Perspektiva e punëtorëve shëndetësor	27
Perspektiva e komunitetit.....	29
Identifikimi i nevojave dhe prioriteteve.....	30
Lista e problemeve.....	30
Prioritizimi i nevojave	31
VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT	32
Vizioni	32
Misioni	32
Objektivi i përgjithshëm	32
Objektivat specifike dhe rezultatet	32
PLANI I VEPRIMIT	34
KORNIZA E MONITORIMIT DHE EVALUIMIT	41

SHKURTESAT

ASK	Agjensioni i Statistikës së Kosovës
AQH	Kujdesi i Qasshëm Shëndetsor dhe cilësor
AMF	Ambulanca e Mjeksisë familjare
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DKSHP	Drejtoria Komunale për Shërbime Publike
DSHPS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
EHKK	Ethet Hemoragjike Krime Kongo
IKPSH	Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor
IKSHP	Instituti Kombëtar I Shëndetit Publik
IP	Iniciativa Pozitive
IR	Instituti Rajonal
KPSH	Kujdesi Parësor Shëndetësor
KFOR	Forca Ndërkombëtare Paqeruajtëse
MF	Mjekësia Familjare
MSH	Ministria e Shëndetësisë
RACI/PLLKI	Responsible Accountable Consulted Informed/ Përgjegjës Llogaridhënës për Konsultim dhe Informim
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
PK	Policia e Kosovës
SISH	Sistemi Informativ Shëndetësor
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Edukimin e Fëmijëve
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Plani Strategjik Komunal për Kujdesin Parësor Shëndetësor 2020-2024 është hartuar me qëllim të përmirësimit të cilësisë të të gjitha shërbimeve shëndetësore sipas nevojave dhe kërkesave të popullatës e që në kohën e fundit vërehet se janë në rritje, duke i shfrytëzuar të gjitha resurset në dispozicion në mënyrë racionale, dhe realizimi i tyre brenda periudhës kohore 5 vjeçare.

Sigurimi i të dhënave analitike për hartimin e Planit Strategjik Komunal (PSK) grupi punues ka përdorur faktet dhe analizat e gjendjes shëndetësore të popullatës, analizën e performancës të institucioneve të KPSH-së nga studimi i Projektit të AQH-së.

Analizat dhe opinionet nga punëtorët e KPSH-së lidhur me problemet shëndetësore më të shpeshta dhe me rrezik më të madh për jetën e pacientëve, faktorët e rrezikut, stili i jetes si dhe aspektet e tjera të shërbimeve shëndetësore që duhen përmirësuar.

Analiza për opinionet e qytetarëve fokus grupe nga qytetarët e lagjeve të qytetit, të fshatrave dhe të OJQ-ve.

Të dhënat zyrtare të siguruara nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK) mbi gjendjen sociodemografike, struktura e moshës, gjinore dhe etnike, ekonomia, shtimi i popullatës, shkalla e natalitetit dhe mortalitetit.

Në bazë të të gjitha të dhënave mund të konkuldojmë se gjendja e përgjithshme e popullatës është e mirë, shkalla e imunizimit të fëmijëve është e lartë dhe e kënaqshme.

Popullata është e kënaqur me shërbimet të cilët iu ofrohen në rrjetin e institucioneve të KPSH të komunës, sipas studimit të cilësisë së Kujdesit Parësor Shëndetësor 2018.

Megjithatë është numri i madh i faktorëve të cilët ndikojnë në jetëgjatësi si faktori socio-ekonomik (varfëria) faktorë të ambientit, duhani, alkooli dhe aksidentet në trafik të cilët janë mjaft të shpeshta.

Të dhënat tregojnë mungesën e resurseve profesionale (Mjek familjar, infermier) dhe atyre material (aparatura medicinale) të cilët ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në organizimin dhe kualitetin e shërbimeve profesionale.

Duke marrë parasysh këto të dhëna DSHPS-ja, QKMF-ja dhe Ministria e Shëndetësisë si dhe organizma të tjerë do të angazhohen në ngritjen e kapaciteteve humane, teknike, financiare dhe të tjera bazuar në nevoja të identifikuar.

Plani i veprimit paraqet aktivitete të cilat do të realizohen në periudhën dy vjeçare me mundësi të korigjimit për periudhë kohore 5 vjeçare.

Prioritetet e prezentuara të Planit të Veprimit paraqesin kahje strategjike të këtij plani i cili do të shërbej si udhërrëfyes profesional me qëllim të përmirësimit të gjendjes shëndetësore të popullatës dhe kënaqshmërinë e pacientëve me shërbimet e ofruara nga institucionet e KPSH-së.

HYRJE

Popullata e shëndoshë potencialisht është resursi më i rëndësishëm i të gjitha segmenteve të zhvillimit, duke kontribuar në zhvillimin gjithëpërfshirës social dhe ekonomik të popullatës. Për këtë fakt duhet t'i kushtohet një vëmendje e posaçme shëndetit dhe kushteve për ruajtjen dhe përparimin e tij.

Sigurimi i bazës ligjore për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit për të gjithë qytetarët nëpërmjet promovimit të vlerave të shëndetit, aktiviteteve parandaluese dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH).

Shëndeti është gjendja e mirëqenies së plotë fizike, mentale dhe sociale, jo vetëm mungesa e sëmundjes dhe dobësisë (OBSH 1946). Për këtë arsye investimi në shëndetësi nuk duhet shikuar si shpenzim, por si investim në shëndet, e me këtë arrijmë një zhvillim të përgjithshëm të popullatës.

Për arritjen e organizimit specifik të nivelit më të lartë të Kujdesit Parësor Shëndetësor, Drejtoria Komonale për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale (DSHPS) dhe ajo e QKMF-së, mbështetur nga projekti AQH-es së bashku me disa akterë të tjerë relevant kanë punuar në hartimin e Master Planit për Kujdesin Parësor Shëndetësor në komunën tonë. Master Plani i punuar është dokumenti i parë strategjik në fushën e shëndetësisë për komunën e Rahovecit, i cili është në harmoni me aktet nënligjore të Ministrisë së Shëndetësisë (UA 13 2002), dhe do të përfshijë në vete, hartimin e strategjisë për zhvillimin e Kujdesit Parësor Shëndetësor, për periudhën 5 vjeçare, bazuar në analizën e situatës aktuale shëndetësore dhe në nevojat e popullatës.

Qellimi i këtij dokumenti është:

- Sigurimi i ofrimit të qëndrueshëm dhe cilësor i të gjitha shërbimeve shëndetësore të ofruara nga institucionet e KPSH
- Krijimi i një baze të mirë për optimalizimin e proceseve organizative, në QKMF
- Organizimi dhe shfrytëzimi racional dhe efikas i të gjitha resurseve në disponim.
- Implementimi i objektivave zhvillimore të komunës së Rahovecit
- Përcaktimi i prioriteteve
- Implementimi i Master Planit, do të vendos bazat drejt krijimit të shërbimeve bashkëkohore të Mjekësisë Familjare

METODOLOGJIA

Duke u nisur nga fakti se komuna e Rahovecit nuk ka pasur Master Planin i cili do të ofronte një kornizë reale për zhvillim të bazuar në dëshmi të këtij sektori me rëndësi, ky plan do të ketë për qëllim t'i ndihmoj drejtuesit KPSH-së në Rahovec të ofrojnë shërbime cilësore, përmes planifikimit adekuat dhe efektiv të burimeve dhe monitorimit të vazhdueshëm të performancës.

Në këtë kontekst autoritet komunale kanë identifikuar nevojën për hartimin e një plani gjithëpërfshirës të KPSH i cili do t'i adresoj në mënyrë adekuate nevojat shëndetësore të komunitetit.

Me datën: 17.05.2018, Kyetari i Komunës, nxorri vendimin nr.01/252/18 për formimin e këshillit drejtues për hartimin e planit shëndetësor të komunës së Rahovecit. Ky këshill ishte gjithëpërfshirës dhe përbëhej nga sektorët relevant, përfshirë edhe shoqërinë civile.

Master Plani është i mbështetur nga AQH e cila ka organizuar trajnime adekuate nga 19.01.2018 e deri në fund të këtij viti sipas orarit të paraparë me ekspertat nderkombëtarë dhe vendor. Trajnimet janë organizuar për drejtorinë e DSHPS-së, drejtorin e QKMF-së, për anëtarët e këshillit drejtues dhe anëtarët e grupit punues, me ç'rast u është ofruar njohuri nga praktikat bashkëkohore në hartimin e Master Planit. Prej datës 10 deri 13 korrik viti 2018 grupi punues për hartimin e master planit në bashkëpunim me ekspertët e kësaj fushe të AQH-së kanë identifikuar dhe përshkruar palët e interesit për këtë projekt, gjegjësisht ndikimin dhe interesin e tyre në këtë plan, në të njëjtën kohë grupi punues ka bërë matricën e caktimit të përgjegjësisë duke përdorur metoden RACI/ PLLKI, dhe kornizën kohore.

Në hartimin e Master Planit janë përdorur faktet edhe analizat e gjendjes shëndetësore të popullatës së komunës së Rahovecit, të bërë nga grupi punues. Gjithashtu janë shfrytëzuar informatat nga vlerësimi i nevojave shëndetësore të komunitetit të realizuar në bashkëpunim me AQH. Kështu më: 29.10.2018, është bërë anketa e punëtorëve shëndetësorë në QKMF, QMF dhe AMF (gjithsej 48 prej tyre), lidhur me problemet kryesore shëndetësore të komunitetit, faktorët e rrezikut dhe aspektet e shërbimeve shëndetësore që duhet përmirësuar.

Nevojat shëndetësore të komunitetit janë evidentuar përmes fokus grupit të datës: 10.12.2018, me përfaqësues të lagjeve të qytetit dhe fshatrave dhe atij të datës: 11.12.2018, me përfaqësues të institucioneve, organizatave dhe OJQ-ve.

Një analizë tjetër shumë e rëndësishme për planifikim të mirëfilltë ishte edhe Studimi i Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor i vitit 2018 nga AQH në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.

Andaj duke patur parasysh metodologjinë e sipërcekur të punës, rezulton që hartimi i këtij dokumenti është bazuar në dy parime kryesore:

- Qasja gjithëpërfshirëse
- Planifikimi i bazuar në dëshmi

Kohëzgjatja e Planit Strategjik do të jetë 5 vjeçare, me mundësi të revidentimit të planit të veprimtimit pas dy viteve.

SFONDI

Qyteti dhe komuna e Rahovecit është e vendosur në pjesën jug-perëndimore të territorit të Republikës së Kosovës, e kufizuar dhe e lidhur me rrjetin e mirë rrugor me Prizrenin, Gjakovën, Suharekën, Malishevën dhe Klinën.

Territori i komunës zë një sipërfaqe prej 275.89 km² të territorit të Kosovës dhe shtrihet në pjesën qendrore të rrafshit të Dukagjinit, me lartësi mbidetare 310m, nga Krusha e Madhe deri në 920m në Zatriq. Shtrihet në hemisferë në mes të shkallës 42° e 30' dhe 42° e 50' të gjerësisë gjeografike veriore dhe ndërmjet 20° e 20' dhe 20° e 55' të gjerësisë gjeografike lindore.

Rahoveci është njeri ndër qytetet më të vjetra të Kosovës. Udhëpërshkruesi i njohur i Perandorisë Otomane nga shekulli XVII Evlia Qelebi gjatë rrugëtimit nëpër territorin e vilajetit të Kosovës e përshkruan Rahovecin si Kasaba (Qyteti i vogël).

Rahoveci është i pasur me relikte të vendbanimeve të dikurshme antike të cilat rrjedhin nga epoka e hershme Romako-Ilire si dhe objekte religjioze e kulturore nga relegjioni Islam dhe Krishter i ritit Ortodoks. Territori i komunës ka një pozitë të mirë gjeografike, sidomos për zhvillimin e bujqësisë dhe agrokulturës. Duke marrë parasysh kushtet e favorshme klimatike dhe agroekologjike puna në bujqësi, vreshtari dhe verari përbën aktivitetin themelor ekonomik në të gjitha aspektet duke përfshirë prodhimin, burimin e të ardhurave dhe punësimin.

Të dhënat sociodemografike

Bazuar në regjistrimin e fundit të vitit 2011 komuna e Rahovecit ka gjithsej 56,208 banorë, shtrirja e popullsisë në komunë është më shumë në zona rurale se ato urbane, me 15,892 apo 28.7% banorë në zonën urbane dhe 40,316 apo 71.3% në zonën rurale.¹ Gjersa bazuar në vlerësimin e paopullatës në vitin 2017 Rahoveci kishte 59.102 banorë²

Dendësia e popullsisë është 204 banorë/km² ku rreth 56,208 banorë jetojnë në 275.9km²

Sa i përket stukturës së moshës në bazë të vlerësimeve të bëra në komunën e Rahovecit dominon mosha e re dhe atë specifike në zonën urbane poashtu dhe rurale. Grup-mosha nga 0-19 vjeç dominon në popullsinë e përgjithshme të komunës me 40%, ndërsa grup-mosha mbi 65 vjeç ka pjesëmarrje më të vogël me vetëm 8.5%.

Struktura gjinore karakterizohet me dominimin jo të madh të gjinisë mashkullore. Koeficienti i maskulinitetit është rreth 105 që do të thotë mesatarisht ekzistojnë 105 meshkuj në çdo 100 femra, pra popullsia mashkullore dominon me 51% në krahasim me atë femërore 49% të popullsisë së përgjithshme.

Struktura etnike - Në aspektin etnik kemi popullsi mjaft homogjene ku mbi 95% të popullsisë janë shqiptarë, sipas të dhënave statistikore nga viti 2003 popullsia shqiptare dominon me 96.68%, serbët 2.72% dhe romët 0.5%.³

¹ Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011, ASK

² Vlerësim-Popullsia e Kosovës 2017, ASK, Prishtinë, Qershor 2018

³ Vlerësimi-Popullsia e Kosoves 2003,ASK

Ekonomia – Papunësia është problemi kryesor i shoqërisë kosovare. Shkalla e papunësisë është 44.4%. Vlerësohet se 1/3 e popullsisë është nën moshën 16 vjeç, ndërsa rreth 60% e popullsisë janë në moshë pune. Kjo shkallë e lartë e papunësisë prek më së shumti femrat (58.06%) dhe kjo papunësi reflektohet edhe në komunën e Rahovecit.

Të punësuar në sektorin ekonomik janë 3.501 apo në 1000 banorë të aftë për punë, vetëm rreth 110 janë të punësuar.

Sipas hulumtimeve UNDP shkalla e varfërisë së përgjithshme është 73.54%, 12.35 % e popullsisë jetojnë me 1 dollarë në ditë për 1 person, 69% jetojnë me 2 dollar ndërsa në varfëri ekstreme jetojnë 10.86% e popullsisë, dhe në varfëri të përgjithshme jetojnë 72.20 %.

Shtimi i popullsisë (shkalla e natalitetit dhe mortalitetit)- bazuar në të dhënat e ASK-së për vitin 2017 janë regjistruar 934 lindje dhe 311 vdekje⁴, rrjedhimisht shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimi natyror janë si më poshtë:

- Shkalla e natalitetit 16 promil
- Mortaliteti 5 promil
- Shtimi natyror i popullsisë 11 promil


⁴ Vlerësim-Popullsia e Kosovës 2017, ASK, Prishtinë, Qershor 2018

ANALIZA E SITUATËS

Gjendja shëndetësore e popullatës

Gjate vitit 2018 sëmundjet më të shpeshta të evidentuara në të gjitha institucionet e KPSH-së janë sëmundjet e sistemit respirator me 33%, pastaj sëmundjet e sistemit digjektiv me 16%, faktorët që ndikojnë në gjendjen shëndetësore dhe shërbime shëndetësore 8%, sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut 7% dhe sëmundjet e sistemit osteo-muskular me 7%. Të dhënat e ilustruara janë në përputhshmëri me të dhënat e sëmundjeve në nivel specifik.

Figura 1. Pjesëmarrja e grupeve të diagnozave në përqindje, 2018




PJESMARJA E GRUPEVE TE DIAGNOZAVE NË %

Mjekësia Familjare

Në shërbimet e Mjekësisë Familjare sëmundjet më të shpeshta që janë regjistruar janë sëmundjet e sistemit respirator me 38%, pasuar nga hipertensioni arterial me 14%, diabetes mellitus 9%, sëmundjet e sistemit osteo-muskular 9%, dhe sëmundjet në bazë të symptomatologjisë 8%, të tjerët 30%.

Figura 2. Diagnozat më të shpeshta në Mjekësinë Familjare, 2018




Vlen të theksohet se numri i pacientëve me insulinë varës në vitin 2018 ka qenë 320.

Njësia e Pedriatisë

Sëmundjet më të shpeshta të regjistruara në shërbimet pediatike janë ato të sistemit respirator me 74%, pasuar nga ato të sistemit gastrointestinal me 10% dhe të tjerat 16%.


Figura 3. Diagnozat më të shpeshta në pediatri, 2018



Gjinekologjia dhe Materniteti

Gjatë vitit 2018 në njësinë e gjinekologjisë dhe maternitetit 57% të pacienteve kanë qenë për vizita që ndërlidhen me shtatëzëninë, përcjellja e shtatëzënieve normale dhe atyre të rrezikuara, në rend të dytë janë vizitat për planifikim familjar me 16%, pastaj çrregullimet menstruale me 6%, inflamacionet e organeve gjenitale 5% dhe dhimbjet abdominale gjithashtu 5%, dhe të tjerat 11%.


Figura 4. Diagnozat më të shpeshta në njësinë e gjinekologjisë dhe maternitet, 2018



Njësia e Urologjisë

Sëmundjet më të shpeshta të evidentuara në këtë njësi janë hipertrofia e prostatës me 20% të rasteve, sëmundjet e fshikëzës urinare gjithashtu me 20% të rasteve, prostatitët 14%, dhe pyellonephritet me 12% dhe të tjerat 34%.

Figura 5. Diagnozat më të shpeshta në urologji, 2018



Sektori i Stomatologjisë

Numri më i madh i pacientëve janë me diagnoza që kanë të bëjnë me çrregullimet e strukturës së dhëmbëve me 75%, dhe kariesi i dhëmbëve me 25%.


Ethet hemoragjike – Krime Kongo

Ethet Hemoragjike Krime Kongo (EHKK) është sëmundje infektive virale që manifestohet me sindromën hemoragjike (gjakderdhje) e cila shfaqet pas thumbimit të rriqrave gjatë sezonës pranverë – vjeshtë. Burimi natyral është lepuri i egër, rriqërat Hyaloma, dreni, iriqi dhe kafshët shtëpiake (lopët, dhitë, delet, kuajtë).

Komuna e Rahovecit është njëra prej zonave hiperendemike të EHKK ku 94% e territorit të komunës është e prekur nga thumbimi i rriqërave. Për shkak të rrezikut, nga pasojat e kësaj sëmundje për shëndetin e popullatës, çdo vjet merren masat mbrojtëse serioze nga qeverisja lokale, QKMF, IKPSH Prishtinë dhe IR i Prizrenit. Para sezonës bëhet hartimi i planit të veprimit në nivel komunal, duke filluar nga mbajtja e ligjëratave në të gjitha shkollat, shpërndarja e fletushkave, emitimi i spoteve përmes Tv aparateve të vendosura në QKMF dhe QMF intervenimi në çdo kohë nga ekipi i ushtruar mirë për largimin e rriqërave, përcjdhja e gjendjes së pacientëve pas thumbimit, raportet ditore, javore, mujore, spërkatja dhe repelimi i kafsheve. Rezultati është përmirësimi i dukshëm i gjendjes nga viti në vit.

Grafikoni më poshtë, tregon rrjedhën e kurbes nga viti 2014 deri në vitin 2018, numri i rasteve të thumbuara nga rriqërat në vitin 2014 ka qenë 280, ndërsa në vitin 2018 numri i rasteve të thumbuara bjen në 180 pra për 100 raste më pak. Fatmirësisht në 5 vitet e fundit raste të vdekjes nuk ka pasur.

Figura 6. Numri i pacientëve të pickuar nga rriqërat, 2014-2018



Organizimi i Kujdesit Parësor Shëndetësor

Shëndetësia në Rahovec ka zanafillën nga viti 1947 me ardhjen e mjekut nga Vojvodina i quajtur me emër Dr. Shandor. Ambulanta e parë është hapur në objektin e Hamamit të qytetit. Pas vitit 1950 bëhet organizimi më i mirë i kujdesit shëndetësor pasi vijnë mjekë edhe nga Prizreni. Në vitin 1959 përrurohet objekti i parë shëndetësor i organizuar si “Shtëpia e Shëndetit”, ku përveç shërbimeve nga mjekësia primare kanë punuar edhe disa shërbime specialiste, e me kohë shtëpia e shëndetit merr formën e një poliklinike.

Në muajin shkurt të vitit 2001 nxirret dokumenti me titull: Strategjia Shëndetësore për Kosovën (Dokumenti i njohur si Libri i Verdhë) dhe kjo strategji solli reforma të dukshme, inicoi Mjekësinë Familjare si gurëthemel i Kujdesit Parësor Shëndetësor.

Kujdesi Parësor Shëndetësor është porta e parë hyrëse në sistemin shëndetësor të Kosovës e cila shërben si pikë koordinuese për të gjitha shërbimet tjera shëndetësore sipas nevojës.

Veprimtaria e Kujdesit Parësor Shëndetësor përfshin promovimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, mjekimin dhe rehabilitimin, që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet, përfshirë kujdesin dentar dhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike mbështetur në konceptin e Mjekësisë Familjare. Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor janë organizuar në bazë të parimeve të cilat janë të përshkruara në Ligjin për Shëndetësi 04/L-125, dhe Udhëzime Administrative të cilat janë në fuqi.

Drejtoria komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si entitet administrativ i sistemit të KPSH-së, e siguron zbatimin e Kujdesit Parësor Shëndetësor përmes zhvillimit dhe zbatimit të politikave shëndetësore, bazuar në ato të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe përmes mbështetjes financiare të sistemit duke e siguruar implementimin e plotë të konceptit të Mjekësisë Familjare.

Rrjeti i Institucioneve Shëndetësore

Shërbimet shëndetësore në komunën e Rahovecit ofrohen përmes rrjetit të institucioneve publike të nivelit parësor i përberë nga Qendra e Mjekësisë Familjare (QKMF) e vendosur në qytet, 7 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) të vendosura në zona rurale (1 në qytet) dhe 7 Ambulantave të Mjekësisë Familjare (AMF) të vendosura në zona rurale (1 në qytet).

Përveç institucioneve shëndetësore publike, shërbimet shëndetësore në komunën e Rahovecit ofrohen edhe në 10 institucione private të licencuara.. Veprimtaria private në sektorin e shëndetësisë bëhet në bazë të principeve të barabarta me sektorin publik të shëndetësisë

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) - është një institucion shëndetësor i cili organizon shërbime shëndetësore në kuadër të Kujdesit Parësor Shëndetësor për qytetarët e komunës së Rahovecit.

Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF) - është në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe ofron shërbime shëndetësore për vendbanime që kanë mbi 5.000 banorë.

Ambulantat e Mjekësisë Familjare AMF - ofrojnë shërbime shëndetësore në zona rurale dhe menaxhohen nga QMF.

Tabela 1. Rrjeti i institucioneve të KPSH sipas lokacionit, mbulueshmërisë, hapësirës, gjendjes aktuale dhe nevojës për rehabilitim, dhe orarit të punës

Institucioni shëndetësor	Fshatrat	Numri i popullatës	Hapësira e objektit m2	Vitet i ndërtimit	Gjendja e tanishme	Nevojat për rehabilitim	Orari i punës
QKMF RAHOVEC	QYTETI	20141	1450			Ne ndërtim	24 h
QMF TE ARRA	QMF TE ARRA		110	2010	E mirë	Nuk ka nevojë	07.00-14.00
AMF LAGJA EPËRME	AMF LAGJA EPËRME		110	2010	E mirë	Nuk ka nevojë	07.00-14.00
QMF RATKOC	RATKOC	3791	800	2012	Shumë e mirë	Nuk ka nevojë	07.00-21.00
	DEJN	1,757					
	DOBIDOL	799					
	GJITH BANORE	6,347					
QMF KRUSHË E MADHE	K MADHE	4473	351.4	2009	E mirë	Pjesërisht	07.00-21.00
	CELINA	1903					
	NAGAVC	743					
	HOQE EVOGEL	1166					
	GJITH BANORE	8285					
QMF BELLACERK	BELLACERK	2270	305	2002	E mirë	Nuk ka nevojë	07.00-14.00
	SOPNIQ	996					
	PATAQAN ULET	1077					
	GJITH BANORE	4343					
QMF DRENOC	DRENOC	1587	374.48	2012	E mirë	Nuk ka nevojë	07.00-47.00
	ZATRIQ	535					
	KAZNIK	164					
	PASTASELL	1011					
	SENOG	687					
	NASHPALL	220					
	PATAQAN I EPËRM	533					
	GJITH. BANORË	4737					
QMF QIFLLAK	QIFLLAK	1292	116.74		Jo e mirë	Tërësisht	07.00-14.00
	KRAMAVIK	1125					
	PITKIVIQ	731					
	MRASOR	191					
	SAROSH	6					
	TOTAL	3345					
QMF APTERUSHE	OPTERUSHË	1911	210.2	2008	Jo e mirë	Tërësisht	07.00-14.00
	RET E EPËRME	771					
	RETI E ULET	234					
	GJITH. BANORË	2916					
AMF XËRXË	XËRXË	3184	226	2015	E mirë	Nuk ka nevojë	07.00-14.00
AMF HOQE E MADHE	HOQE E MADHE	124	250		Jo e mirë	Nuk ka nevojë	07.00-14.00
AMF ZAQISHT	ZAQISHT	659	226	2006	E mirë	Nuk ka nevojë	07.00-14.00
AMF PALLUZHE	PALLUZHE	808	250	2016	E mirë	Nuk ka nevojë	07.00-14.00
AMF BRESTOC	BRESTOC	1288	185	2010	E mirë	Nuk ka nevojë	07.00-14.00
AMF RADOSTE	RADOSTE	2346	185	2015	E mirë	Nuk ka nevojë	07.00-14.00

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

QKMF është institucion shëndetësor kryesor i KPSH në territorin e komunës së Rahovecit.

Në aspektin operacional bën promovimin, parandalimin, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin e pacienteve. QKMF si qendër administrative e KPSH-së kryen organizimin dhe menaxhimin e punës në qendër dhe në të gjitha institucionet e KPSH-së. Siguron selektimin dhe distribuimin e personelit mjekësor sipas nevojave dhe kërkesave të popullatës por duke u bazuar në kapacitetet profesionale dhe teknike të cilat i ka në dispozicion. Puna e institucionit mbështetet dhe mbikqyret nga Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHPS) së cilës njëherit edhe i raporton.

QKMF është e organizuar:

1. Departamenti MF
2. Departamenti i Administratës dhe Personelit

Departamenti i MF

- Sektori i MF
- Sektori i Shëndetit Publik
 - Njesia e SISH-t
 - Njesia e Vakcinimit dhe Imunizimit
- Sektori i Shëndetit Oral Preventiv
- Sektori i Diagnostikës
 - Kabineti i Radiologjisë
 - Laboratori
- Sektori Konsultativ i Departamentit të MF-së
 - Njesia e Pediatriisë
 - Njesia e Urologjisë
 - Njesia e Gjinekologjisë dhe Maternitetit.
- Barnatore Qendrore

Departamenti i Administratës


- Zyra e Personelit
- Zyra Juridike
- Zyra për Buxhet dhe Financa
- Zyra për Shërbime Teknike

Departamenti i Administratës udhëhiqet, organizohet dhe mbikqyret në mënyrë të drejtperdrejtë nga drejtori.

Shërbimet shëndetësore në KPSH


Gjate vitit 2018 janë realizuar 101,145 vizita mjekësore ku 48,784 ose 48% kanë qenë pacientë të gjinisë femërore, ndërsa 52,361 ose 52% të gjinisë mashkullore.

Figura 7. Vizitat mjekësore sipas gjinisë, 2018



Numrin më të madh të vizitave apo 49% e ka bërë popullata e moshës 20 deri 64 vjeçare, pasuar nga moshat 0 deri 19 vjeçare me 34%, dhe moshë 65 e më tepër vjeçare me 17% të vizitave.

Figura 8. Vizitat mjekësore sipas grupmoshave, 2018




Në tabelën vijuese janë prezentuar shërbimet gjatë vitit 2018 sipas institucioneve. Është e pritshme që QKMF të ketë numrin më të madh të shërbimeve por ajo çfarë është brengosëse është numri shumë i vogël i shërbimeve në disa institucione dhe rrjedhimisht kosto-efikasiteti i tyre duhet analizuar me kujdes dhe të propozohen masat adekuate.

Tabela 2. Vizitat mjekësore dhe shërbimet sipas institucioneve, 2018

Institucioni	Vizita mjekësore	Shërbime tjera	Gjithsej shërbime
QKMF – Mjekësia Familjare	51,174	79,169	130,343
QKMF – Pediatria	14,191	19,742	33,933
QKMF – Materniteti	3,472	1,221	4,693
QMF Ratkoc	8,475	8,360	16,835
QMF Krushë e Madhe	6,717	5,804	12,521
QMF Opterushë	3,230	3,551	6,781
QMF Bellacerk	2,855	5,181	8,036
QMF Drenoc	1,325	2,501	3,826
QMF Rahovec	1,099	250	1,349
QMF Cifllak	837	1,994	2,831
AMF Xërxe	5,354	4,342	9,696
AMF Lagja e Epërme	1,359	1,234	2,593
AMF Radoste	917	2,418	3,335
AMF Brestoc	140	127	267


QKMF në Rahovec ka ofruar 73% të shërbimeve të gjithëmbarshme edhe pse në qytetin e Rahovecit banojnë vetëm 35% e popullatës së komunës së Rahovecit. Vërehet se në QMF-të dhe AMF-të ofrojnë me përqindje më të vogël shërbime se që është nr. i banorëve. Presim që ky trend të përmiresohet, pasi që në vitin 2019 kemi organizimin e ofrimit të shërbimeve në dy ndërrime në QMF Ratkoc dhe Krushë e Madhe.

Figura 9- Raporti i shërbimeve të ofruara në raport me nr. e banorëve



Vërehet një rritje në kontinuitet i numrit të vizitave dhe shërbimeve, ku në vitin 2014 ishin 88,966 vizita mjekësore, ndërsa në vitin 2018 kemi 101,145 vizita. Qartas shihet se kemi një rritje prej 14% të vizitave të realizuara në vitin 2019. Poashtu kemi rritje substanciale të numrit të shërbimeve krahasuar me 2014 për 52%. Këtë numër duhet lexuar edhe si zgjerim i gamës së shërbimeve të ofruara në QKMF.

Figura 10. Trendi i shërbimeve përgjatë viteve 2014 -2018



Burimet njerëzore

Në KPSH të komunës së Rahovecit punojnë 123 punëtorë shëndetësor, prej tyre 37 janë kuadër superior, 5 kuadër i lartë, 65 kuadër i mesëm dhe 16 janë punëtorë jo mjekësor. Prej numrit të përgjithshëm 65 janë meshkuj dhe 58 janë të gjinisë femërore, mosha mesatare e punëtorëve është 48.6 vjet.

Numri i specialistëve nga MF është: 3, Mjekësia e Përgjithshme-1, Pediatria-2, Gjinekologjia- 1, Radiologjia- 1, Biokimia- 1, Urologjia -1. Numri i mjekëve në specializim nga MF është: 4- Pediatria, 1- Emergjencia, 1- Gjinekologjia. Ndërsa numri i mjekëve pa specializim është: 12. Numri i Stomatologëve është: 7, njeri prej tyre është Pedodontë. Kuadër i lartë janë: 2- Infermier, 2 - teknik Laboratori dhe 1 - teknik i Radiologjisë. Kuadri i mesëm: 41- Infermierë të përgjithshme, 2 të Pediatrisë, 1 teknik i Radiologjisë, 3 teknikë Laboratori, 1 asistent i Stomatologjisë dhe 13 mami.

Të dhënat tregojnë mungesë të theksuar të mjekëve familjarë si bartës kryesorë për funksionalizimin e konceptit të Mjekësisë Familjare në IKPSH. Duke marrë parasysh numrin e përgjithshëm të banorëve në komunë dhe formulën e OBSH-se 1 mjek familjarë për 2000 banorë atëherë QKMF-së i duhen së paku 15 mjekë dhe 16 infermiere.

Tabela 3. Mjekët dhe Infermieret sipas institucioneve të KPSH

Institucioni	Mjek	Infermier	Orari
QKMF Rahovec	23	44	24 h
QMF te Arra	0	1	07.00-14.00
QMF Krushë e Madhe	3	6	07.00-14.00
QMF Ratkoc	3	7	07.00-14.00
QMF Bellacërk	1	1	07.00-14.00
QMF Drenoc	1	1	07.00-14.00
QMF Qiflak	1	2	07.00-14.00
QMF Opterushë	1	0	07.00-14.00
AMF Xërxë	1	3	07.00-14.00
AMF Radoste	1	1	07.00-14.00
AMF Rahovec i Lartë	1	0	07.00-14.00
AMF Hoqë e Madhe	0	0	07.00-14.00
AMF Zogisht	0	0	07.00-14.00
AMF Polluzhë	0	0	07.00-14.00
AMF Brestoc	0	0	07.00-14.00
Gjithsejtë	36	66	

Sipas formulës së OBSH 1 = 2000-2500 banorë, QKMF Rahovec ka nevojë edhe për: 15 mjekë familjar, 18 infermierë, 4 stomatolog dhe 5 asistent stomatologjie.

Pajisjet

QKMF disponon me pajisjet dhe aparaturë medicinale kryesisht funksionale e blerë nga komuna. Rëndësia e pajisjeve në diagnozë, dhe në kapacitetin e trajtimit të pacientëve është e madhe, por edhe mjaftë e kushtueshme. QKMF edhe përkundër kostos ka nevojë për investime dhe atë kryesisht në sektorin e diagnostikës. Dhomat e intervenimeve në MF dhe kujdestari kanë: Defibrilator, EKG, Aspirator, O₂ aparate, Inhalator Set për intervenime reanimuese, 4 QMF dhe 1 AMF kanë EKG. Ordinancat e mjekëve janë të pajisura me aparate bazike, këtu duhet cekur ndihmën e rradhës në vitin 2018 nga AQH për 8 ordianca me të gjitha aparatet e parapara për mjekun familjar dhe 1 Ekg 12 kanalësh mjaftë të sofistikuar.

Të dhënat e plota për paisje dhe aparaturë në annex.

Furnizimi me barna dhe material shpenzues

Furnizimi me barna dhe material sanitar në QKMF, QMF dhe AMF bëhet nga Departamenti i Farmacisë/Ministria e Shëndetësisë. Planifikimi, transporti, distribuimi, bilanci dhe raportet e rregullta i kryejnë farmacisti dhe tekniku i farmacisë.

Sipas analizës së nevojës për barna të bazuar në planifikim vjetor të barnatores qendrore dhe furnizimit nga MSH, rezulton se nevojat e KPSH për barna nga lista esenciale mbulohen vetëm 20%.

Buxheti virtual i ndarë nga Ministria e Shëndetësisë për vitin 2018 ka qenë 126,297.87 euro, nga kjo vlerë për insulinë janë shpenzuar 75,778.70 € ose 60% (numri i pacienteve insulinë -varës në vitin 2018 ka qenë 320) pjesa tjetër e buxhetit është shpenzuar për barëra esenciale dhe material sanitar, sasia e cila nuk ka plotësuar nevojat dhe kërkesat e pacienteve.

DSHPS i Komunës ka ndarë shumë e parave prej 8,314.40 € për sigurimin e barnave në raste urgjente. QKMF gjatë vitit 2018 është ballafaquar edhe me një vështirësi në sigurimin e barnave të ampulluara (Moditen depo, Haldol, Akineton) për pacientët e shëndetit mendor (numri i tyre në vitin 2018 ka qenë 60) pasi Qendra e Shëndetit Mendor në Gjakovë e ka ndërprerë furnizimin e QKMF-së me keto barna për këtë kategori të ndijshme të pacienteve. Mbetet që DSHPS të gjejë mënyrën për ti dalë në ndihmë këtyre pacienteve.


Financimi i shërbimeve shëndetësore

Sistemi i Kujdesit Parësor Shëndetësor financohet nga Grandi për Shëndetësi dhe të hyrat vetanake.

Buxheti i KPSH-se së Rahovecit për vitin 2018 është 1,630,710.7 Euro.

Grafikoni 10 tregon shpërndarjen sipas kategorive të buxhetit për vitin 2018

Figura 10. Shpërndarja e buxhetit të KPSH sipas kategorive buxhetore, 2018



Bashkëpunimi me sektorët tjerë

Bashkëpunimi ndërmjet sektorëve është një veprimtari e rëndësishme ndërmjet sektorit të shëndetësisë dhe akterëve të tjerë të cilat në varësi nga natyra e veprimtarisë së tyre ndikojnë në përmirësimin e shëndetit të popullatës. Kjo praktikë në institucionin tonë ka kohë që është instaluar e në veçanti me QPS, AQH, DKA, me OJQ: SHL-Kosova, Harea, Hendikos, IP, me PK, Kryqi i Kuq i Kosovës, Caritas Kosova, Organizatat ndërkombëtare OBSH, UNICEF, UNDP, KFOR. Ndihma në donacion nga Zyra e Ambasadës së Japonisë dhe Agate nga Suedia.

Sektori shëndetësor privat

Sektori i shëndetit privat në komunë është i organizuar në bazë të principeve të njëjta me sektorin publik të rregulluar me ligj Nr.04/L-125 neni 15.

Janë regjistruar 10 ordinanca specialistike të licencuara kryesisht në qytet, 7 ordinanca Stomatologjike, 2 laboratore, dhe 14 Barnatore. QKMF nuk posedon ndonjë dokument zyrtar në lidhje me ndonjë formë të bashkëpunimit me sektorin privat.

Ky sektor kontrollohet nga MSH dhe ka rëndësi në ofrimin e disa shërbimeve shëndetësore të cilat nuk i ofron KPSH.

Cilësia e kujdesit shëndetësor

Për ngritjen e cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor QKMF organizon auditime klinike dhe rishqyrtime kolegjiale. Gjithashtu me mbështetjen e AQH-së aktualisht është duke u punuar në zhvillimin e sistemit të mbikqyerjes mbështetëse, përfshirë mekanizmat për mbledhjen e opinioneve/ankesave të komunitetit, si dhe në ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e cilësisë.

Në dy vitet e fundit është bërë auditimi dhe ri-auditimi për shfrytëzimin e kartelave shëndetësore. Megjithatë, me qëllim të sigurimit të të dhënave bazë, lidhur me cilësinë e shërbimeve të KPSH-së, AQH projekti ka realizuar një studim⁵ i cili ka vlerësuar cilësinë e shërbimeve të Kujdesit Parësor Shëndetësor në Rahovec si më poshtë:

Infrastruktura

Shumica e shërbimeve shëndetësore, me përjashtim të shërbimeve për tuberkuloz, ofrohen në QKMF. Shërbimet ndryshojnë në QMF të ndryshme, p.sh. nuk ofrohet shërbimi i imunizimit dhe shërbimet e planifikimit familjar në QMF.

Infrastruktura e institucioneve shëndetësore është në përgjithësi e pastër dhe mirëmbajta ndryshon varësisht nga institucioni, për shembull jo të gjitha institucionet shëndetësore kanë qasje të vazhdueshme në energji elektrike dhe qasje në infrastrukturën teknike (kompjuter, printer, internet)

Aspektet higjienike janë në përgjithësi të mira, edhe pse disponueshmëria e dezinfektuesve dhe qasja në tualete nuk ishte e kënaqshme, në veçanti në QMF-të.

Udhërrëfyesit dhe materialet informuese nuk janë plotësisht në dispozicion në institucionet shëndetësore.

Pajisjet e shërbimit gjinekologjik janë në dispozicion vetëm në QKMF. Medikamentet nga lisat esenciale nuk janë plotësisht në dispozicion në institucionet shëndetësore. Gjersa QKMF ka të

⁵ Studimi i Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor 2018, Raporti Pëmbledhës Komuna Rahovec, AQH, Shkurt 2019

gjitha pajisjet e avansuara në dispozicion dhe QMF-të nuk kanë shumicën e pajisjeve të avansuara në dispozicion. Disa nga pajisjet themelore të KPSH-së mungojnë në secilin institucion shëndetësor dhe disa nuk ishin në dispozicion në asnjërin nga institucionet shëndetësore.

Proceset – Observimet klinike

Respektimi i parimeve të anamnezës së pacientit dhe ekzaminimit fizik sillej nga 71% dhe 75%. Kjo do të thotë që tek institucionet e ndryshme shëndetësore mjekët respektonin shumicën e aspekteve të konsultave mjekësore.

Parandalimi dhe kontrolli i infeksionit nuk është shumë i kënaqshëm në të gjitha institucionet shëndetësore. Rezultatet tregojnë që në rastet kur janë nevojitur masa për parandalimin dhe kontrollin e infeksionit, zakonisht nuk janë kryer.

Rezultatet lidhur me konsultat mjekësore të pacientëve me hipertension dhe diabet janë të ulëta. Ndërsa pas konsultimit me pacientët për arsye tjera nga diabeti apo hipertensioni, janë gjetur rezultate më të mira.

Kënaqshmëri me shërbimet shëndetësore

Në përgjithësi shumica absolute e pacientëve janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimet e pranuar, duke u bazuar gjithnjë nga raporti përmbledhës i studimit të cilësisë së Kujdesit Shëndetësor 2018 për komunën e Rahovecit.

Vlerësimi i nevojave shëndetësore të komunitetit

Vlerësimi i nevojave të komunitetit është realizuar nga ekspertët e AQH-së në bashkëpunim me këshillin drejtues për hartimin e masterplanit të KPSH-së të komunës së Rahovecit.

Qasja e përdorur është bazuar në metodën sasiore dhe cilësore të grumbullimit të të dhënave për nevojat shëndetësore të komunitetit nga dy perspektiva të ndryshme, përkatësisht të ofruesve të kujdesit shëndetësor dhe atë të përfaqësuesve të komunitetit.

Punëtorët shëndetësor nga të tre nivelet, QKMF, QMF dhe AMF, kanë plotësuar një pyetësor të vetë-administruar. Në pyetësor u kërkua që të renditen tre probleme kryesore shëndetësore, faktorë të rrezikut dhe aspektet e shërbimeve të kujdesit shëndetësor që duhet të përmirësohen në komunën e tyre.

Në fazën e dytë, janë mbajtur dy diskutime në fokus grupe, një me përfaqësuesit e komunitetit, lagjeve/fshatrave dhe një me aktorët tjerë relevantë si Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Arsim, QKMF, spitalet rajonale, institutet rajonale të shëndetit publik dhe organizatat e shoqërisë civile OJQ-të që përfaqësojnë grupe specifike të popullsisë, duke përfshirë grupet e cënueshme.

Në këto fokus grupe u diskutua për pyetjet e mëposhtme:

- “Cilat çështje janë më të rëndësishme për një komunitet të shëndetshëm në komunën tuaj?”
- “Pse këto çështje janë më të rëndësishme/prioritare për ju?”
- “Kush (cila popullatë është më e prekur nga këto çështje?”

- “Çfarë duhet të bëjnë autoritetet komunale të shëndetësisë për t’i adresuar këto çështje?”

Perspektiva e punëtorëve shëndetësor

Problemet e shëndetësore të komunitetit

Lidhur me problemet shëndetësore të komunitetit, **sëmundjet kardiovaskulare/hipertensioni dhe diabeti** janë renditur si prioriteti i parë, ndërsa **sëmundjet e frymëmarrjes dhe kanceri** janë vlerësuar si prioritet i dytë dhe e tretë respektivisht:

- I. Sëmundjet kardiovaskulare / Hipertensioni (92%)
- I. Diabeti (92%)
- II. Sëmundjet respiratore (51%)
- III. Kanceri (21%)
- IV. Shëndeti Mendor (13%)
- V. Sëmundjet infektive (8%)
- VI. Shëndeti i nënës dhe fëmijës (6%)
- VI. Lëndim /traumë (6%)

Faktorët e rrezikut

Përdorimi i duhanit, obeziteti/mbipesha, dhe mungesa e aktivitetit fizik, janë renditur si faktorë kryesor të rrezikut në komunitet. Në Rahovec abuzimi i alkoolit renditet shumë lartë, krahasuar me komunat e tjera:

- I. Përdorimi i duhanit (77%)
- II. Obeziteti/mbipeshë (71%)
- III. Mungesa e aktivitetit fizik (60%)
- IV. Abuzimi me alkool (35%)
- V. Ndotja e ajrit (24%)
- VI. Mbeturinat dhe toksinat (21%)
- VII. Uji dhe kanalizimi (8%)
- VIII. Abuzimi i substancave (4%)

Aspekte të Kujdesit Shëndetësor që duhet përmirësuar

Edukimi dhe promovimi shëndetësor, cilësia e shërbimeve dhe qasja në shërbime, mbeten prioritetet kryesore për ndërhyrje edhe në komunën e Rahovecit.

- I. Promovimi/edukimi shëndetësor (94%)
- II. Cilësia e shërbimeve të KPSH⁶ (66%)
- III. Qasja në shërbimet e KPSH⁷ (52%)
- IV. Programe dhe shërbime në komunitet (35%)
- V. Kujdesi i integruar⁸ (29%)
- VI. Përfshirja dhe fuqizimi i komunitetit (23%)

⁶ Definicioni i OBSH-së për cilësinë e kujdesit është “niveli me të cilën shërbimet shëndetësore të ofruara i përmirësojnë rezultatet shëndetësore. Për të arritur këtë, kujdesi shëndetësor duhet të jetë:

- I sigurt – shërbime shëndetësore që minimizojnë rrezikun dhe dëmin e pacientëve, përfshirë evitimin e lëndimeve të parandalueshme dhe reduktimin e gabimeve mjekësore.
- Efektiv - ofrimi i shërbimeve që bazohen në njohuri shkencore dhe udhërrëfyes të bazuar në evidence.
- Në kohë të duhur – Reduktimin e vonësave në dhënien dhe marrjen e kujdesit shëndetësor.
- Efikas - shërbime shëndetësore që maksimizojnë shfrytëzimin e burimeve dhe evitojnë humbjet.
- Barabartë - shërbime shëndetësore pa dallime në cilësi sipas karakteristikave individuale siç janë gjinia, raca, etniciteti, lokacioni gjeografik apo statuti socioekonomik..
- Pacienti/Individi në qendër – shërbime që marrin në konsiderim preferencat dhe aspiratat të individëve që shfrytëzojnë shërbimet si dhe kulturën e komunitetit të tyre.

⁷ Sipas OBSH-së Qasja në shërbime ka tri dimensionet:

- Disponueshmëria fizike – të paturit në dispozicion shërbime të mira shëndetësore në distancë të arsyeshme për popullatën që ka nevojë për këto shërbime, si dhe orarin e punës, sistemin e caktimit të vizitave dhe aspektet tjera të organizimit dhe ofrimit të shërbimeve që ju mundëson popullatës të marrin shërbimet kur kanë nevojë për to.
- Arritshmëria financiare – mundësia e popullatës për të paguar për shërbime shëndetësore pa patur ngarkesë të madhe. Merr parasysh jo vetëm çmimin e shërbimeve shëndetësore, por edhe koston indirekte dhe atë të paplanifikuar (p.sh. koston e transportit për në institucion shëndetësor dhe kthim mbroptë, si dhe koston e mungesës nga puna). Arritshmëria ndikohet nga sistemi i gjërë i financimit shëndetësor dhe nga të hyrat familjare.
- Pranueshmëria – vullneti i popullatës për të shfrytëzuar shërbimet. Pranueshmëria është e ultë kur pacientët kanë perceptim se shërbimet janë jo efikase apo kur faktorët social dhe kulturor siç janë gjuha, moshë apo gjinia, etniciteti apo religjioni i ofruesve të shërbimeve shëndetësore i dekurajojnë ata për të kërkuar shërbime..

⁸ Kujdesi i integruar: “Kujdesi i integruar definohet si qasje për të fuqizuar sistemin shëndetësor me pacientin/individin në qendër përmes promovimit të ofrimit të shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse të dizajnuara sipas nevojave multidimensionale të popullatës dhe individit, të ofruara nga një ekip i kordinuar multidiciplinar që punojnë në nivele dhe sektorë të ndryshëm të kujdesit – OBSH, 2016

Perspektiva e komunitetit

Pjesëmarrësit në fokus grupe që përfaqësojnë institucionet/organizatat, janë dakorduar se problemi kryesor është mungesa e edukimit shëndetësor. Komuniteti nuk ka njohuri themelore për shëndetin dhe masat parandaluese, ushqimin e shëndetshëm dhe higjienën. Një çështje tjetër është se ka vetëm një pediatër në sektorin publik.

Mendimi i përfaqësuesëve të komunitetit është se ka tre probleme kryesore, duke përfshirë mungesën e mjekëve, ndotjen e tokës dhe ujit, si dhe cilësinë e dobët të ushqimit të konsumuar. Sipas tyre, Rahoveci i mungojnë së paku 35 punonjës mjekësor bazuar në numrin e banorëve.

Përfaqësuesit e institucioneve/OJQ-ve

- Ushqyshmëria e dobët e fëmijëve dhe të rriturve, ushqimi nuk monitorohet
- Mungesa e aktivitetit fizik në përgjithësi,
- Zbatimi i dobët i strategjisë së shërbimeve të KPSH
- Vetëm një pediatër, asnjë neuropsikiatër
- Mungesa e edukimit / promovimit të shëndetit për fëmijë
- Mungesa e strategjisë për personat me aftësi të kufizuara,
- Kushtet socio-ekonomike janë përgjithësisht të dobëta
- Mungon qasja e duhur për persona me aftësi të kufizuara
- Furnizim i dobët me barna esenciale
- Mjekët hezitojnë të kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara
- QKMF është vetëm një mjek gjatë ndërrimit të natës
- Infrastruktura e dobët e objekteve shëndetësore
- Barnatoret shesin barna pa receta
- Mungesa e ndërgjegjësimit të qytetarëve rreth parandalimit
- Nuk ka mjek / dentist në shkollë
- Fëmijët nuk kanë dijeni për higjienën orale
- Nuk ka vetëdije për rëndësinë e kontrolleve rutinore
- Uji i pijshëm nuk është i sigurt për shkak të tubacioneve të vjetra
- Rritja e numrit të të rinjve që abuzojnë me droga
- Laboratori në QMF nuk funksionon
- Komuniteti RAE nuk është i vetëdijshëm për vaksinimin

Popullata kryesisht më shumë e prekur nga çështjet shëndetësore të cekura lartë përfshijnë të rinjtë dhe fëmijët, njerëzit me kushte të vështira socio-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet RAE.

Autoritetet komunale të shëndetit duhet të ndërmarrin aktivitetet e mëposhtme në mënyrë që të adresojnë në mënyrë të përshtatshme këto çështje:

Përfaqësuesit e institucioneve/OJQ-ve

- Përmirësimi i komunikimit me qytetarët lidhur me nevojat e tyre në mënyrë që të priorizohen investimet shëndetësore
- Realizimi i fushatave ndërgjegjëse në shkollë (shëndeti oral, abuzimi me droga)
- Inspektorët sanitar duhet të inspektojnë dyqanet e ushqimit
- Kontrollët shëndetësore rutinore me ekupe mobile për të moshuarit,
- Përmirësimi i furnizimeve me barna esenciale
- Edukimi/promovimi shëndetësor për RAE
- Sigurimi i shërbimeve mobile për vaksinim (RAE)
- Zbatimi i fondit të sigurimeve shëndetësore,
- Kontrollimi i barnatoreve që shesin barna pa recetë.

Përfaqësuesit e komunitetit

- Nuk ka laboratore në QMF dhe AMF
- Mungesa e reagensave për laboratorë
- Uji i pijshëm është i ndotur nga mbeturinat,
- Numri i ulët i stafit mjekësor në institucionet mjekësore në Rahovec.
- Mungesa e mjekëve me përvojë
- Teknikët dhe mjekët jokompetent për të përdorur pajisjet e disponueshme
- Ushqyshmëria jo e shëndetshme
- Mungesa e edukimit shëndetësor në mesin e qytetarëve në përgjithësi
- Mungesa e barnave esenciale

Përfaqësuesit e komunitetit

- Kontrollimi i rregullt ushqimit
- Kontrollimi i rregullt i cilësisë së ujit
- Personeli duhet të respektojë orarin e punës (rurale)
- Edukim/promovimi shëndetësor për studentët
- Realizimi i vizitave sistematike në zonat rurale
- Sigurimi i furnizimit të mjaftueshëm me barna esenciale
- Rritja e buxhetit të shëndetit
- Rritja e numrit të specialistëve të MF (rural)
- Kryerja e fushatave të ndërgjegjësimit (zonat rurale të përqendruara në parandalimin)
- Përmirësimi i mirëmbajtjes së institucioneve shëndetësore
- Sigurimi i shërbimeve të vizitave në shtëpi

Identifikimi i nevojave dhe prioriteteve

Lista e problemeve

Grupi punues për hartimin e masterplanit duke u bazuar në analizën e situatës aktuale si dhe në studimet tjera relevante ka identifikuar këto probleme të përgjithshme të Kujdesit Parësor Shëndetësor e komunën e Rahovecit.

- Zbatimi i konceptit të Mjekësisë Familjare në QKMF, QMF dhe AMF.
- Burimet njerëzore, mungesa e mjekëve familjar dhe infermiereve.
- Mungesa e listave të pacientëve për ekipet e MF.
- Aftësimi profesional i ekipeve shëndetësore për emergjencë, orari i punës 3 ndërrime.
- Edukimi dhe promovimi shëndetësor.
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore në KPSH.
- Instalimi i sistemit të llogaridhënies.
- Funksionalizimi i shërbimit të kujdesit shtëpiak permanent dhe atij paliativ.
- Promovimi i shëndetit oral dhe kujdesit themelor stomatologjik posaqërisht për fëmijë parashkollor dhe shkollor.
- Përmirësimi i higjienës në të gjitha qendrat e KPSH-së.
- Funksionalizimi i SISH-it.
- Shfytëzimi i rregullt i kartelave shëndetësore.
- Pajisjet funksionale të komunikimit, kompjuter, printer në çdo qendër të KPSH.
- Përmirësimi i mekanizmit të referimit.
- Disponueshmëria me pajisjet e avancuara në diagnostikë dhe në njesitë tjera të KPSH.
- Analiza serioze nga aspekti i kosto-efikasitetit për disa AMF.
- Infrastruktura jo e kënaqshme në dy QMF (Qifllak dhe Opterushë)
- Sigurime shëndetësore.
- Ambienti i jashtëm i ndotur.
- Ethet Hemoragjike

Prioritizimi i nevojave

Prioritizimi i nevojave është bërë duke shfrytëzuar njërin nga instrumentet e menaxhimit të cilësisë nga trajnimet e realizuara nga AQH projekti.

Nr	Problemi dhe/apo zgjidhja e propozuar	Lehtësia e zgjidhjes së problemit 1-5 *(4)	Kostoja 1-5* (3)	Fisibiliteti arritshmëria 1-5*(2)	Kohëzgjatja 1-5 *(1)	Përfitimi i pacientëve 1-5*(5)	Pikët
1	Funksionalizimi i SISH-it	20	15	10	5	25	75
2	Paisjet funksionale të komunikimit, kompjuter printer në çdo qendër të KPSH	20	15	10	5	25	75
3	Përmirësimi i mekanizmit të referimit	20	15	10	5	25	75
4	Edukimi dhe promovimi shëndetësor	16	15	10	4	25	70
5	Instalimi i sistemit të llogaridhënies	16	15	10	4	25	70
6	Ethet hemoragjike	16	12	8	5	25	66
7	Aftësimi i ekipeve shëndetësore për emergjencë, orari i punës tre (3) nderime.	16	12	8	4	25	65
8	Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore në KPSH	16	12	8	3	25	64
9	Mungesa e listave të pacientëve për ekipet e MF	16	12	6	4	25	63
10	Funksionalizimi i shërbimit të kujdesit shtëpiak permanent dhe atij paliativ	16	12	6	4	25	63
11	Infrastruktura jo e kënaqshme në disa pika shëndetësore	16	12	8	2	25	63
12	Paisja dhe evidentimi i pacientëve me kartela shëndetësore fizike dhe elektronike	12	12	8	4	25	61
13	Zbatimi i konceptit të MF në QKMF, QMF dhe AMF	12	12	8	2	25	59
14	Përmirësimi i higjienës në të gjitha qendrat e KPSH-së	8	12	6	4	25	55
15	Burimet njerëzore, mungesa e mjekëve familjar dhe infermiereve	12	9	6	2	25	54
16	Disponueshmëria me pajisjet e avancuara në QKMF dhe njësitë tjera të KPSH	16	6	6	1	25	54
17	Promovimi i shëndetit oral dhe kujdesit themelor stomatologjik, posaqërisht për fëmijë parashkollor dhe shkollor	12	3	6	3	25	49
18	Sigurimet shëndetësore	4	3	2	1	25	35
19	Ndikimi i ambientit të jashtëm në shëndet	4	3	2	1	25	35
20	Analiza serioze nga aspekti i kosto-	8	6	2	2	15	33

VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT

Vizioni

Shërbimet shëndetësore cilësore dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit.

Misioni

Misioni i QKMF-së si institucion bartës i Kujdesit Parësor Shëndetësor bazohet në ofrimin e shërbimeve shëndetësore efikase bashkëkohore dhe cilësore përmes prevencës, kurativës, diagnostikës dhe shërbimeve terapeutike.

Objektivi i përgjithshëm

Ky plan bazohet në objektivat dhe rezultatet e Strategjisë Sektoriale Shëndetësore të Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës, 2017-2021, andaj edhe objektivi i përgjithshëm është të kontribuoj në ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të popullatës në komunën e Rahovecit

Objektivat specifike dhe rezultatet

Objektivi specifik 1:

1.0 Institucionet e KPSH-së ofrojnë shërbimet shëndetësore cilësore dhe adekuate të bazuara në nevojat dhe kërkesat e popullatës.

- R.1.1. Kapacitet e ekipit të Mjekësisë Familjare të fuqizuara.
- R.1.2. Infrastruktura dhe pajisjet e IKPSH të përmirësuara
- R.1.3. SISH – Sistemi i Informimit Shëndetësor i Përmirësuar
- R.1.4. Kapacitetet e ngritura të përgjegjësve shëndetësor për planifikimin gjithëpërfshirës dhe të bazuar në dëshmi, si dhe për monitorimin e vlerësimit të shërbimeve cilësore dhe kosto efikase të KPSH-së.
- R.1.5. Mekanizmat e menaxhimit të cilesisë të fuqizuara
- R.1.6. Masat për parandalimin e infeksioneve të zbatuara në të gjitha IKPSH.
- R.1.7. Furnizimi me produkte medicinale i të gjitha institucioneve të KPSH-së i përmirësuar.
- R.1.8. Menaxhimi i mbetjeve mjekësore i përmirësuar.

Objektivi specifik 2:

2.0 Popullata e komunës praktikon sjellje të shëndetshme.

R.2.1 Popullata e vetëdijësuar për faktorët e rrezikut

R.2.2 Kapacitet e fuqizuara të këshillimoreve për sëmundjet kronike jo-infektive

R.2.3 Popullata e vetëdijësuar për ruajtjen e ambientit.

R.2.4. Shërbimet në komunitetet e avancuara.

PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit në vijim mbulon dy vitet e para të masterplanit. Pas periudhës dyvjeçare do të rishikohet plani strategjik dhe do të përpilohet plani i veprimit për periudhën e mbetur të masterplanit i cili do të reflektoj situatën ekzistuese në atë moment si dhe strategjitë relevante të niveli qendror dhe atij komunal.

Logjika e intervencimit/zinçkimit rezultateve	Indikatori	Vlera afërsisht	Vlerat e synuara												Institucioni përgjegjës	Buxheti indikativ	Burimet financimit
			2020				2021										
			T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4			
Objektivi i përgjithshëm: Ruajtja dhe përpaltimi i shëndetit të popullatës së komunës së Rahovecit	Jetëgjatësia e pritur në lindje	76.7 vjet (në nivel vendi)	NA												DSHMS QKMF MSH	1,106,525€	DSHPS, MSH Donatorët
Objektivi specifik 1: Instruicioni i KPSH ofron shërbimet shëndetësore cilësore dhe adekuate të bazuara në nevojat dhe kërkesat e popullatës.	Rritje për 20% e numrit të vizitave mjekësore në IKSH	100,145 (2018)	NA												DSHMS QKMF MSH	1,081,685€	DSHPS MSH Donatorët
Rezultati 1.1: Kapacitetet e ekipit të MF të fuqizuara.	Rezultati i konsultimeve klinike sipas AQH	52%	NA												DSHMS QKMF MSH	234,200 €	MSH, DSHPS, Donatorët
Activiti 1.1.1 <i>Trajnimi i 20 MF në trajtimin e HTA bazuar në protokollin e MSH</i>			5	5	5	5									QKMF	2,000 €	DSHPS
Activiti 1.1.2 <i>Trajnimi i 20 mjekëve familjarë për trajtimin e diabetes mellitus (sëmundja e sheqerit, bazuar në protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë).</i>			5	5	5	5									QKMF	2,000 €	DSHPS
Activiti 1.1.3 <i>Trajnimi i 20 infermierëve për trajtimin e sëmundjes së HTA,së.</i>			5	5	5	5									QKMF	2,000 €	DSHPS
Activiti 1.1.4 <i>Trajnimi i 20 infermierëve për trajtimin e diabetes mellitus (sëmundja e sheqerit, bazuar në protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë).</i>			5	5	5	5									QKMF	2,000 €	DSHPS
Activiti 1.1.5 <i>Trajnimi i 3 mjekëve në QKUK (klinika emergjente).</i>			1	1	1	1									QKMF	1,500 €	DSHPS

Aktiviteti 1.1.6 Trajtimi i 8 infermierëve në QKUK (klinika emergjente).		2	3	3													QKMF	2,400 €	DSHPS
Aktiviteti 1.1.7 Ndërtimi i 8 infermierëve në Mjekësi Familjare për 4 mjekë		4															QKMF	Pa kosto	DSHPS
Aktiviteti 1.1.8 Punësimi i 15 mjekëve të Përgjithshëm								15									DSHPS	121,500 €	DSHPS, MSH
Aktiviteti 1.1.9 Punësimi i 16 infermierëve me përgatitje të lartë shkollë								16									DSHPS	100,800 €	DSHPS, MSH
Rezultati 1.2: Infrastruktura dhe paisjet e IKPSH të përmirësuara																	DSHPS QKMF	741,000 €	MSH, DSHPS, Donatorët
Aktiviteti 1.2.1 Ndërtimi i objektit të QMF-së Opterushë.																	DSHPS	85,000 €	DSHPS
Aktiviteti 1.2.2 Furnizimi me inventar për nevojat e QMF-së Opterushë																	DSHPS	5,000 €	DSHPS
Aktiviteti 1.2.3 Ndërtimi i objektit QMF-së Qifllak.		1															DSHPS	50,000 €	DSHPS
Aktiviteti 1.2.4 Furnizimi me inventar për nevojat e QMF-së Qifllak																	DSHPS	5,000 €	DSHPS
Aktiviteti 1.2.5 Furnizimi me inventar për QKMF Rahovec.		1															DSHPS	80,000 €	DSHPS
Aktiviteti 1.2.6 Renovimi i objektit të QKMF-së ndërtues eksistuese																	DSHPS	300,000 €	DSHPS
Aktiviteti 1.2.7 Furnizimi me mamograf																	QKMF	65,000 €	DSHPS/Donacion
Aktiviteti 1.2.9 Furnizimi me 1 pajisje ECHO për QKMF																	QKMF	15,000 €	DSHPS
Aktiviteti 1.2.9 Furnizimi me pajisje mjekësore për Emergjencë (1 Defibrilator me Monitor, 2 komplete të intubimit-laringoskop, Ultrasonograf-USG, 3 shtrëtarë për reanimim, 1 respirator portable, 1 Crash-Care tavolina, 3 ambu maska për të rritur 2 pediatrike dhe 1 infantile, 1 negatoskop.																	QKMF	60,000 €	DSHPS/Donacion
Aktiviteti 1.2.10 Furnizimi i pajisjeve laboratorike për QKMF																	QKMF	10,000 €	DSHPS
Aktiviteti 1.2.11 Furnizimi me 2 karrika stomatologjike për 2 QMF																	QKMF	8,000 €	DSHPS
Aktiviteti 1.2.12 Furnizimi i 14 EKGve (7 për QMF dhe 7 AMF)																	QKMF	14,000 €	DSHPS

Aktiviteti 1.2.13 <i>Furnizimi me Ortopan në repartin e stomatologjisë</i>		1								QKMF	2,000 €	DSHPS
Aktiviteti 1.2.14 <i>Furnizimi me 14 Komputera së bashku me printer për nevojat e QMF-ve dhe AMF-ve</i>		14								QKMF	7,000 €	DSHPS
Aktiviteti 1.2.15 <i>Blerje e një Autoambulance</i>			1							QKMF	35,000 €	DSHPS
Rezultati 1.3: SISH – Sistemi i Informimit Shëndetësor i Përmirësuar	Përqindja e pacientëve me kartela shëndetësore elektronike dhe/apo fizike të përditësuara rregullisht	24% (2018)	NA							MSH	14,950 €	MSH
Aktiviteti 1.3.1 <i>Furnizimi me klient zero (monitor), për laborator, rentgen, stomatologji (22 copa).</i>			22							MSH	5,500 €	MSH
Aktiviteti 1.3.2 <i>Instalimi i rrjetit për nevojat e SISH-it</i>		1								MSH	1,000 €	MSH
Aktiviteti 1.3.3 <i>Furnizimi me 14 Gjenerator për nevojat e QMFve dhe AMFve</i>			7						7	MSH	7,000 €	MSH
Aktiviteti 1.3.4 <i>Trajnimi i personelit shëndetësor për SISH (30 punëtorë shëndetësor)</i>		30								MSH	450 €	MSH
Aktiviteti 1.3.5 <i>Trajnimi i 2 punëtorëve për mirëmbajtjen e SISH-it.</i>		2								MSH	1,000 €	MSH
Rezultati 1.4: Kapacitetet e ngritura të përgjegjëse shëndetësor për planifikimin gjatëpërshirës dhe të bazuar në dëshmi, si dhe për monitorimin e vlerësimit të shërbimeve cilësore dhe kosto efikase të KPSH-se.	Korniza e monitorimit dhe evaluimit të këtij plani është e përditësuar rregullisht	Aktualisht nuk ka kornizë të M&E	NA							QKMF, DSHPS	8,315 €	DSHPS, Doantoret
Aktiviteti 1.4.1 <i>Trajnimi i 7 përgjegjëse të njesive.</i>		3	4							QKMF	915 €	Donatorët
Aktiviteti 1.4.2 <i>Monitorimi i implementimit të strategjisë bëhet në baza të rregullta 6 mujore.</i>			1		1				1	QKMF	400 €	DSHPS

Aktiviteti 1.4.3 Një studim i detajuar lidhur me kosto-efikasitetin e rrjetit ekzistues të KPSH																		DHSPS QKMF	5,000 €	DSHPS
Aktiviteti 1.4.2 Hartimi i planit të riorganizimit të rrjetit të KPSH-bazuar në gjetjet e kostoefikasitetit																		DHSPS QKMF	2,000 €	DSHPS
Rezultati 1.5: Mekanizmat e menaxhimit të cilësisë të fuqizuara																		QKMF	8,070 €	DSHPS, Donatorët
Aktiviteti 1.5.1 Kordinatori i cilësisë organizon 2 takime njoftuese për mekanizmat e cilësisë me 15 mjekë dhe 30 infermiere																		QKMF	100 €	DSHPS Buxheti Komunal
Aktiviteti 1.5.2 Kordinatori i cilësisë harton planin vjetor për menaxhimin e cilësisë në QKMF dhe i propozon Këshillit Drejtues për miratim	1																	QKMF	Pa kosto	DSHPS Buxheti Komunal
Aktiviteti 1.5.3 Kordinatori i ZHVP implementon planin vjetor të ZHVP-es të akredituar nga Odat profesionale për 30 mjekë dhe 65 infermier																		QKMF	1,000 €	DSHPS Buxheti Komunal
Aktiviteti 1.5.4 Komiteti i cilësisë i udhëhequr nga Koordinator i cilësisë takohet njëherë në 3 muaj me qëllim të ngritjes së cilësisë, së shërbimeve, duke bërë SWOT analizë	1																	QKMF	240 €	DSHPS Buxheti Komunal
Aktiviteti 1.5.5 Kordinatori i cilësisë organizon 4 punëtori në dy vitet e para, mbikqyrja mbështetëse për 123 punëtorë.																		QKMF	1,230 €	DSHPS Buxheti Komunal
Aktiviteti 1.5.6 Në fund të dy viteve të zhvillohet anketa nga ana e ndonjë OJQ-eje në lidhje me kënaqshmërinë e pacientëve me shërbimet e ofruara nga ana e KPSH																		QKMF	3,000 €	DSHPS Buxheti Komunal
Aktiviteti 1.5.7 Realizimi i shqyrtimeve kolegjale në baza tremujore, bazuar në nevojat e identifikuara për përmirësim të cilësisë																		QKMF	500 €	DSHPS

Aktiviteti 2.1.3 <i>Fushata mediale për faktorët e rrezikut dhe promovim të stilit të shëndetshëm të jetesës, 4 fushata</i>	1		1		1		1		1		1		1,200 €	QKMF	DSHPS
Aktiviteti 2.1.4 <i>Vizita sistematike nëpër shkollë dhe çerdhe të fëmijëve (24 shkollë dhe 1 qerdhe)</i>	3	3	3	3	3	3	3	3	3	4			400 €	QKMF	DSHPS Buxheti Komunal
Aktiviteti 2.1.5 <i>Organizimi i radio emisioinit 4 herë për dy vite, tema: Promovimi i jetës së shëndetshme, ndikimi i duhanit, alkoolit, drogës dhe pijeve energjetike</i>		1				1			1	1			1,200 €	DSHPS	DSHPS Buxheti Komunal
Aktiviteti 2.1.6 <i>Organizimi nga ana e DSHPS dy tryeza të rumbullakta me persona publik të profilave të ndryshme, me qëllim të promovimit të jetës së shëndetshme</i>			1							1			700 €	DSHPS	DSHPS Buxheti Komunal
Aktiviteti 2.1.7 <i>Dy fushata sensibilizuese kundër Pickinit te rriqrave (Ethet Hemoragjike Krime Kongo)</i>		1							1				5,000 €	QKMF	DSHPS, DKA, QKMF
Rezultati 2.2: Kapacitetet e fuqizuara të këshillimoreve për sëmundjet kronike jo-infektive														QKMF	DSHPS Buxheti Komunal
Aktiviteti 2.2.1 <i>Trajnimi i 2 infermierëve të IKPSH-së për këshillim motivues për SKJ.</i>	2												300 €	QKMF	DSHPS Buxheti Komunal
Aktiviteti 2.2.2 <i>Trajnimi 1 ditor, 1 infermier, 7 QMF, 7 AMF, për ofrimin e këshillave motivuese për sëmundjet SKJ</i>													540 €	QKMF	DSHPS Buxheti Komunal
Aktiviteti 2.2.3 <i>Informimi i popullatës për rëndësinë e këshillimoreve për SKJ dhe faktorë rreziku përmes radios lokale</i>												1	1,000 €	QKMF	DSHPS Buxheti Komunal
Rezultati 2.3: Popullata e vetëdijesuar për ruajtjen e ambientit														QKMF	DSHPS
Aktiviteti 2.3.1 <i>Dy prezantime nga mjekët familjar nëpër shkollë fillore dhe të mesme (24) për rëndësinë e ambientit dhe ndikimin e tij në shëndet</i>	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6		2,400 €	QKMF	DSHPS

Aktiviteti 2.3.2 <i>Ligjërata përmes radios lokale në ditën ndërkombëtare të tokës, tema: Si ta ruajmë ambientin - 2 ligjërata</i>		1					1											QKMF	200 €	DSHPS
Aktiviteti 2.3.3 <i>Organizimi i një ekspozite vjetore nga ana e DSHPS për qytetarë në lidhje me "Ambient i pastër e ruan shëndetin"</i>	1						1											QKMF	1,000 €	DSHPS
Aktiviteti 2.3.4 <i>Organizimi nga ana e Kryetarit të Komunës me DSHPS, DKA dhe DKSHP i aksionit vjetor për pastrimin e ambientit</i>			1										1					QKMF	2,000 €	DSHPS
Rezultati 2.4: Shërbimet në komunitetet e avancuara.																		QKMF	7,200 €	DSHPS
Aktiviteti 2.4.1 <i>10 vizita mujore të kujdesit shtëpiak për sëmundjet e rënda kronike (2 infermier në dispozicion)</i>	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	QKMF	2,400 €	DSHPS Donatorët
Aktiviteti 2.4.2 <i>20 vizita shtëpiake kujdesi ndaj nënës dhe fëmijës, çdo 3 muaj (2 infermier në dispozicion)</i>	20	20	20	20	20	20	20	20	20	20	20	20	20	20	20	20	20	QKMF	1,600 €	DSHPS Donatorët
Aktiviteti 2.4.3 <i>10 vizita mujore në shtëpi për kujdesin paliativ. (2 infermier në dispozicion)</i>	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	QKMF	2,400 €	DSHPS Donatorët
Aktiviteti 2.4.4 <i>10 vizitat mjekësore për personat me sëmundje mendore, çdo tre muaj. (2 infermier në dispozicion)</i>	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	QKMF	800 €	DSHPS Donatorët

KORNIZA E MONITORIMIT DHE EVALUIMIT

Afrim Dina

Kryesuesi i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **30.08.2019**, me fillim në ora **10:15**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, drejtor të drejtorive Komunale, përfaqësues të OSBE-së, gazetarë, media, dhe ju kuvendarë të nderuar, po ju lexoj rendin e ditës:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozimit të Kryetarit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale,
5. Informatë mbi implementimin e Planit për investime në hapësirat e hapura publike në Komunën e Rahovecit,
6. Rishqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores Komunale për Transparencë Komunale 2019.

Pikët shtesë

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të komunës për nisëm e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim midis Komunës së Rahovecit dhe Komunës së Frascineto,
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të komunës për nisëm e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim midis Komunës së Rahovecit dhe Komunës së Civita.

Kryesuesi – Të nderuar kuvendarë komuna jonë do të lidhë një marrëveshje apo binjakëzim me dy komuna nga shteti Italian, e ato janë Frascineto dhe Civita. Kjo marrëveshje do të lidhet me 22 Shkurtë, dhe neve si komunë na është kërkuar nga MAPL-ja që në kuvend të merret një vendim për aprovim të kësaj marrëveshje, prandaj para se të filloj me procedimin e rendit të ditës, kërkoj nga ju që ti votoni edhe këto dy pika shtesë për këtë mbledhje. I qes në votim këto dy pika që i prezantova të jenë pikat shtesë për këtë mbledhje: Konstatohet se unanimisht është aprovuar propozimi që të përshihen edhe këto dy pika shtesë për këtë mbledhje të kuvendit. Tani të nderuar kuvendar/e a ka dikush të shtoj diçka sa i përket rendit të ditës,

nëse jo e qes në votim rendin e ditës së bashku me këto dy pika shtesë: Konstatohet se unanimisht është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi – A ka dikush të jap ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar?

Ali Zhuniqi – Përsëritet për të gjithë të pranishmit në sallë, të nderuar tek diskutimi imë në procesverbal kam vërejtur që ka mangësi, sepse nuk më është përfshirë i gjithë diskutimi, prandaj kishte me qenë mirë që personat që janë përgjegjës të kenë kujdes dhe çdo fjali që ne e themi këtu të evidentohet në procesverbal.

Kryesuesi – Të nderuar gjithsesi se këto vërejtje do të përmirësohen, a ka edhe dikush ndonjë vërejtje apo sugjerim, nëse jo e vë në votim Procesverbalin nga mbledhja e kaluar: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë (1) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Rexhep Oruqi – Përsëritet për të gjithë të pranishmit në sallë, do i ngrisë dy çështje, e para është në cilën fazë ka arritur ndërtimi i rrugës Rahovec Potoqan, duke e ditur se që katër vite ka filluar që të rregullohet kjo rrugë dhe tani ka mbetur ende pa përfunduar. Kam kaluar një ditë në atë rrugë dhe e pashë që asfaltin i kësaj rruge ka nisur të dëmtohet, për arsye se nuk e ka ende shtresën e dytë, mirëpo kjo rrugë nuk ishte e përfunduar as me shtresën e parë deri në fshatin Patoqan. Pyetje e datë ka të bëjë me rrugën e cila kalon në oborrin e ish fabrikës 18 Nëntori, të nderuar ne në kuvend e kemi marrë një vendim ku e kemi shpallur si interes të përgjithshëm, por sipas informatave që i kam nga tre pronarë sa janë në këtë rrugë, njëri nga pronarët është ankuar dhe tani procedura ka shkuar në gjykatën themelore në Prishtinë. Përsëri po e cekim se sipas informatave që i kam edhe në gjykatë ka përfunduar procedura në favor të komunës së Rahovecit, kjo rrugë e lidhë lagjen e Kërstit me pjesën tjetër të qytetit. Pres që të na jep më shumë informata drejtori për këto dy pyetje që i parashtrava.

Mirjeta Krasniqi – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, pyetje ime ka të bëjë me DKA-në, a ka organizuar ndonjëherë komuna e Rahovecit transport për nxënësit e Kramovikut, Guri të Kuq, Çifllak dhe Polluzhë, pra që ti dërgoj deri në fshatin Ratkoc pasi që ky fshat gjendet më afër këtyre vendbanimeve. Diku rreth 50-60 nxënës nga këto fshatrat që i përmenda shkojnë në shkollën e mesme në Gjakovë, e di që nuk kemi të drejtë ne të ju imponojmë atyre shkollimin e mesëm, por nëse komuna e tyre ka shkollë të mesme pse të shkojnë ata në ndonjë qytet të komunës tjetër të vijojnë shkollimin e mesëm. Me këtë veprim ne humbim deri 60 orë që i bie diku të humbim 3 mësimdhënës, pra nëse nuk ka pasur ndonjëherë ky transport, kërkoj që të sigurohet ky transport për këto fshatra që i përmenda më parë.

Afërdita Thaqi – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje për Kryetarin e Komunës, i nderuar a jeni në dijeni për nxjerrje të zhavorrit në fshatin Çifllak, pasi që shfrytëzuesit e pandërgjegjshëm të zhavorrit kanë filluar që të marrin zhavorr dhe me këtë kanë filluar që ti dëmtojnë edhe ato pak rrugica që kanë mbetur pa u dëmtuar. Po ashtu me këtë janë duke e shkatërruar edhe mjedisin hapësinorë, çdo njëri që e ka njohur atë pjesë për bukuri natyrore, por tani është bërë një çoroditje nga askush tjetër por vetë nga faktori njëri. Prandaj kërkoj nga kolegët e mijë kuvendarë që të më përkrahin në këtë iniciativë, ku i kërkoj kryetarit të komunës që të i dërgoj inspektoratin dhe të i ndërpresë punimet atyre. Problemi tjetër që dua të parashtoj është, mos ndërtimi i trotuarit që të qon nga fshati e deri tek fusha e sportit, kjo pjesë është e frekuentuar më së shumti nga fëmijët sepse në këtë rrugë shkojnë edhe në shkollë, prandaj e lusë kryetarin që të përshpejtoj procedurat dhe të ja fillojë sa më parë ndërtimi i këtij trotuari. Po ashtu kërkoj që ky trotuar të i plotësoj kriteret e një trotuari, të ketë gjerësinë e nevojshme, prandaj sa më shpejtë aq më mirë sepse tani ja fillon mësimi dhe fëmijët janë të rrezikuar nga makinat kur kalojnë në këtë pjesë. Kërkesa ime tjetër është që të vendosen disa policë të shtritë tek hekurudha, një tek kafiteria Cani dhe një tek kooperativa e Çifllakut, këto janë për ne banorët e Çifllakut çështjet emergjente.

Refki Kryeziu – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, kohëve të fundit nga niveli qendrorë Ministria e Infrastrukturës ka bërë ndërtimin e disa rrugëve në komunën tonë, por këto rrugë nuk janë duke u përfunduar ashtu si duhet. Vlen të theksohet se rruga transite mbi qytetin e Rahovecit është pa mbrojtje

anësore, në këtë rrugë mundet shumë lehtë të vije deri tek ndonjë fatkeqësi, prandaj kishte me qenë mirë që sa më shpejtë të mirën masa ndaj kësaj çështje. Po ashtu ju kisha bërë me dije që të shikoni dhe ndërtoni edhe këto rrugë ekzistuese, vlen të theksohet rruga Fortes – Patoqan i Ulët dhe i Epërm, kjo rrugë është tepër e amortizuar, prandaj mirë kishte me qenë që edhe në këtë rrugë të mirën masa për sanimin e saj. Pasi jemi në fillim të vitit shkollor, ne disa që i përkasim arsimit që disa ditë kemi filluar që të paraqitemi në shkolla, dje me datë 29.08.2019 kolektivi i shkollës së lartë profesionale “Selajdin Mullabazi – Mici”, që i përkas edhe unë vetë këtij kolektivi kemi mbajtur një mbledhje. Në këtë mbledhje mungoi Drejtoresha e kësaj shkolle znj. Vjollca Vuçitërna, në diskutim e sipër me kolektivin disa thanë që është suspenduar, kurse disa tjerë thanë që është larguar nga puna, ajo që neve na intereson është që të na tregoj Kryetari i ose drejtori i DKA-së, çka ka ndodhur realisht me këtë drejtoresh.

Fehmi Cena – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, desha ta ngrisë një çështje e cila u përmend më parë nga z. Oruqi, sa i përket rrugës Rahovec – Potoqan i Ulët, ka dy tre vite që është duke u ndërtuar kjo rrugë, ajo që bie në sy është se punimet janë duke u zhvilluar shumë ngadalë. Një pjesë është asfaltuar dhe asfalti nuk është aspak cilësor dhe ka filluar që të dëmtohet, pastaj ka ankesa nga qytetarët se në zgjerimin e kësaj rruge disa bujqve është duke ju marr shumë tokë nga vreshtat e tyre dhe nuk pyeten për asgjë. Një vërejtje që una ta praques rreth ndërtimit të kësaj rruge është çështje e ndërtimit të një ure tek pjesa e kësaj rruge tek livadhet e Dublanës. Më parë kur ka qenë kjo rrugë me zhavorr ka qenë edhe një urë, në momentin kur ka filluar të ndërtohet kjo rrugë është prishur kjo urë dhe e kanë futur një gyp deri në një metër gjerësi, por ky gyp nuk i plotëson kushtet që të i kryej rolin e urës. E pyes drejtorin a është paraparë që në këtë projekt të jetë ura sepse aty është një grykë e madhe dhe sa herë bie shi tani aty krijohen vërshime dhe nëse kjo rrugë asfaltohet kështu me këtë gyp atëherë do të dëmtohet sa herë që do të ketë reshje.

Ali Zhuniqi – Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike, kemi marr disa ankesa nga bashkëfshatarët rreth rrugës që të dërgon nga Fortesa në fshatin Celin, janë dy ose tre vende që është dëmtuar goxha shumë kjo rrugë sidomos tek pjesa e cila përçon nga lagja e Zhuniqve dhe një pjesë afër fshatit Celin, në këtë pjesë një shok i imë e ka dëmtuar makinën dhe riparimi i saj ka kushtuar diku rreth 500,00. €, prandaj duhet të mirën masa urgjente që të riparohet kjo rrugë. Kemi diskutuar edhe më herët për vazhdimin e projektit të lumit i cili përçon në fshatin Fortesë, keni thënë se për shkak të mos respektimit të kontratës nga ana e kompanisë i keni ndërprerë kontratën, tani dua ta di se në cilën fazë janë punimet dhe a ka gjasë që kjo punë të rregullohet më shpejtë për arsye se jemi duke u ofruar stinës së dimrit, pastaj siç e dini vërshimet janë zakonisht të mëdha dhe por rezulton pastaj në dëmtime në ekonomi familjare. Shqetësimi tjetër është sa i përket kompanisë për mbledhje të mbeturinave e cila është kontraktuar nga komuna, kjo kompani nuk i merë gjërat e lëngshme, arsyeja e tyre është se nuk e kanë të përshtirë në kontratë këtë shërbim. Për mendimin time kjo mundet të jetë edhe e arsyeshme, për arsye se kam parë një herë kur është ndalur kamioni i cili i ka marrë mbeturinat dhe një sasi e lëngut u derdhke në rrugët e fshatit, kjo i kontribuon infeksioneve dhe u jep influencë për përhapje të gripit. Mendoj se drejtori i shërbimeve publike duhet të bisedoj me këto kompani dhe të shikojnë se cilat janë gjasat që të sanohen këto probleme.

Munib Durguti – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlihem rreth çështjes që e ngrita në seancën e kaluar, bëhet fjalë për tre pengesa që kanë qenë në rrugë afër palestrës Mizahir Isma, në seancën e kaluar e kem ngritur çështjen që këto pengesa në rrugë ose policë të shtrirë kanë qenë pa shenjëzuar. Por pas adresimit të kësaj çështje në seancën e kaluar, i menjëhershëm ka qenë reagimi i drejtorisë për shërbime publike dhe premtimi i kryetarit të komunës së kjo do të kryhet, dhe brenda një afatit prej 10 dite këto pengesa janë shenjëzuar dhe tani gjithçka është në rregull. I falënderoj për këtë veprim dhe i kujtoj se një bashkëpunim në mes qeverisjes dhe kuvendit shkon në dobi të qytetarëve, poashtu besoj se do të ngritët edhe pjesa tjetër e shqetësimit që e kam ngritur në seancën e kaluar, ajo është vendosja e një pengese afër trafo stacionit tek gjimnazi Xhelal Hajda – Toni, po ashtu është e nevojshme edhe vendosja e një pasqyre për qasje më të lehtë në rrugën Gëzim Hamza – Piktori, meqenëse është një rrugë goxha e ngarkuar dhe ka disa rrugica anësore të cilat e vështirojnë qasjen në atë rrugë.

Rrukije Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetje ime shkon për drejtorin e DKA-së, dua ta di se sa munden të pajisen nxënësit tonë në shkolla me libra sipas planeve korekulare, meqenëse mungesa e librave sipas planeve korekulare do të na paraqes një problem dhe një kaos. Nëse e marrim një shembull të vetë planit të klasës së gjashtë dhe klasës së shtatë nga lënda e biologjisë do të punojnë me tre libra, pra klasa e gjashtë ka me punuar me librin e klasës së 6,8 dhe 9, kurse klasa shtatë do të punojë me librat e klasës së 6,7 dhe 9. Do të jetë shumë e vështirë për nxënësit dhe një punë shumë e vështirë për mësëdhënësit, harmonizimi i librave me planet korikulare kishte me qenë një lehtësim shumë i madh.

Trajko Shariq – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetje ime ka të bëjë rreth rrugës e cila fillon nga Sahat Kulla e deri tek ambulanca në lagjen e epërme të Rahovecit, po ashtu edhe të gjitha rrugët tjera t cilat gjenden në lagjen e epërme janë të dëmtuara. Po ashtu edhe me ndriçim publik kemi probleme në lagjen e epërme, kemi mungesa në disa vende të ndriçimit publik, ne po ashtu edhe me çështjen e kanalizimit po kemi probleme sepse gypat e kanalizimit janë të dëmtuara dhe në disa vende derdhet jashtë uji i fekaleve, u shkakton dëme tek banorët si të komunitetit serb ashtu edhe shqiptare dhe atij RAE.

Kryesuesi – Ju falënderoj për pyetjet e bëra, nëse ka ndonjë prej drejtorëve që të ju jep tani përgjigje fjala është e tyre, nëse jo atëherë munden në mbledhjen e ardhshme të ju përgjigjen, po ashtu kanë mundësi edhe me shkrim të ju përcjellin përgjigjet.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, i nderuari z. Rexhep Oruqi, sa i përket rrugës Rahovec Potoqan, ky është një projekt i vjetër i vitit 2016/2017, por për shkak të mungesës buxhetore dhe për shkak të kontratës e cila është e madhe është duke hezitur punë kryesi të i kryej punët pa i pasur mjetet e zotuar. Kjo është njëra nga shkaqet kryesore që është neglizhuar puna në këtë segment, përndryshe për momentin jemi duke punuar dhe duke bërë disa drenazhime të asaj rruge sepse ka pasur disa dëmtime nga shtresës së parë të asfaltit, po ashtu jemi duke u marrë me një pjesë të urës që e ceku edhe doktori. Po ashtu do të shikojmë mundësin që të bëjmë edhe disa zgjerime sepse kjo ka qenë edhe kërkesë e bujqve, sepse është krijuar jo një qasje e mirë për disa banorë që të kyçen tek arat e tyre, ne po ashtu kemi bërë kërkesë edhe në ministri për mbështetje financiare për këtë projekt sepse jemi minus edhe 400,000.00 € që të mbyllet projekti në tërësi. Sa i përket rrugës tek ish fabrike 18 Nëntori i nderuar ajo është çështje ligjore dhe nuk na përket neve, por në momentin që vije vendimi final ne do të planifikojmë ndërtimin e kësaj rruge. Sa i përket trotuareve që bërë pyetje e nderuara znj. Afërdita Thaqi, po e nderuar jam i i njoftuar por shpresojmë vitin e ardhshëm do të ndajmë mjete më shumë sa i përket ndërtimit të trotuareve, dhe besoj se do të realizojmë shtrimin e trotuareve edhe në atë pjesë. Në këtë vit në fshatin tuaj është duke u ndërtuar Ndriçimi, QMF-ja dhe disa investime tjera. I nderuari z. Refki Kryeziu sa i përket rrugës së transitit që është mbi qytetin e Rahovecit, ky ka qenë një projekt i vjetër të cilin e kemi trashëguar dhe e kemi realizuar. Por në kuadër të këtij projekti nuk kanë qenë të parapara mbrojtësit e rrugës, prandaj ne e kemi realizuar ashtu siç ka qenë projekti, tani ne kemi bërë kërkesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe besoj se shumë shpejtë do të bëhet edhe kategorizimi i rrugës, pra ta merë përsipër Ministria e Infrastrukturës këtë rrugë. Kurse në projektin katër kursi Rahovec Xërxë është parapara edhe mbrojtësit anësor, prandaj besoj se si të lidhet kontrata do të realizojmë këtë premtim. Kurse sa i përket rrugës Rahovec - Potoqan i Poshtëm jam i vetëdijshëm që kjo rrugë është e dëmtuar, por ashtu edhe rruga Fortes - Celinë është shumë e dëmtuar, ne kontratën për mirëmbajtje të rrugëve e kemi të lidhur, por kemi mungesë të buxhetit për të realizuar këtë vit, shpresoj se vitin e ardhshëm në pranverë do të realizojmë këto dy segmente se me të vërtet janë në gjendje jo të mirë. I nderuari z. Fehmi Cena sa i përket pyetje suaj i dhashë përgjigje, por po ju them se ne jemi aty jemi duke punuar në këtë rrugë, kanë ardhur edhe disa kërkesa sepse kanë filluar të dalin banorët edhe me vendbanime në këtë pjesë. Ne kemi disa kërkesa nga ta për shtrimin e rrjetit të rrymës elektrike, por të ju them të drejtën ne kemi në mungesë në draft Rregulloren për Taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, për shfrytëzimin e gypave nëntokësor, por në mbledhjet e ardhshme do të kërkoj ndihmën e juaj që të futen këto taksa që ata qytetar që dëshirojnë të i shfrytëzojnë këto gypa të paguajnë një taksë të vogël në momentin që kyçen, pra vetëm një herë e jo të taksohen çdo vit. I nderuari z. Ali Zhuniqi sa i përket kompanive për mbledhje të mbeturinave, është e vërtet sepse kemi edhe ankesa tjera nga banorët, por është e vërtet që

kompanitë nuk mundën të i ngarkojnë me gjëra të lëngshme kamionin për mbeturina sepse kur shkojnë të i hedhin mbeturinat duhet të paguajnë tonazhin e mbeturinave. Faleminderit i nderuari z. Munib Durguti për fjalët që i thatë sa i përket pengesave në rrugë, ne jemi bashkërisht këtu dhe çdo shqetësim tuajin do të mundohemi që ta përcjellim në teren. Kurse sa i përket sinjalizimit dhe pengesave tjera në rrugë, ne deje kemi marrë vendim për një grupe punues së bashku me policin e Kosovës, ekspertët e komunikacionit dhe zyrtarët e komunës dhe besoj se shumë shpejtë do të dalim në qytet që ti verifikojë të gjitha këto probleme. I nderuari z. Trajko Shariq rrugët janë të dëmtuara, ne e kemi kompaninë për mirëmbajtje të rrugëve do ti autorizoj që ta vizitojnë atë pjesë dhe të shohin se çka mundet të bëhet, kurse sa i përket kanalizimit ka mundësi të ketë ndonjë bllokim, është kompania KRU – Gjakovae cila mirët me de bllokimin e tyre, prandaj është mirë që të ja adresoni atyre kërkesën, por do të shohim edhe ne se çka mundemi të bëjmë. Kurse sa i përket ndriçimit publik ne e kemi paraparë që në rrugën Bekim Isma të bëjmë ndriçimin e ri me standarde, kjo është në proces të kontraktimit dhe si të lidhet kontrata do të ndriçojmë edhe atë rrugë.

Fehmi Cena – I nderuar pyetje ime ishte konkrete a është e paraparë që të ketë urë, sepse ajo rrugë do të jetë e përhershme dhe nuk do të jetë rrugë fushore, nëse nuk është paraparë mirë është të parashihet.

Përparim Krasniqi – I nderuar ne jemi duke i ekzekutuar punimet sipas projektit që është paraparë për rrugën Rahovec – Potoqan, nëse mungon në projekt ura, atëherë ne mundemi me dalë në teren dhe të shikojmë se çka mundemi të bëjmë. Përndryshe aty janë vendosur disa gypa për qarkullim të ujit, po ashtu pak më poshtë gjendet edhe ura.

Afërdita Thaqi – Edhe unë e kam një pyetje sa i përket rrugës Rahovec – Potoqan, kur ka qenë e paraparë kjo rrugë të përfundoj dhe sa kanë qenë të paraparë të bëhen pagesat për këtë rrugë sepse nuk kemi kurrfarë informacione.

Përparim Krasniqi – E nderuar kontrata është 845,000.00 €, e cila është lidhur në vitin 2016 kontrata dhe është dashur të kryhet në vitin 2018, por për shkak të mungesës së mjeteve është shtyrë edhe këtë vit, por nëse kemi mjete shtesë në këtë vit e autorizojmë kompaninë dhe kemi mundësi me që të përfundojmë projektin.

Kryesuesi – Ju faleminderit drejtor, të nderur kuvendar përgjigjet tjera në pyetjet e parashtruara do i merrni në mbledhjen e radhës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik.

Artan Asllani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, para vete keni propozimin e kryetarit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, pronë shtetërore e Komunës së Rahovecit e cila gjendet zonën kadastrale në Xërxe tek depot e ish Matreksit. Hapësira e kësaj zone sipas certifikatës është 5587 m², por në shfrytëzim jepet vetëm hapësira prej 800 m². Qëllimi i dhënien në shfrytëzim i kësaj prone është që të ngritët vlera e asaj prone, si dhe të ju jepet në shfrytëzim personave që janë të interesuar të shfrytëzojnë veprimtaritë e tyre që kanë qëllim rritjen e kapaciteteve të punës. Afat për dhënie të kësaj parcele e keni të përcaktuar në vendim në pikën 1 dhe 2, nga 1 -15 vite, po ashtu çmimi fillestar për dhënie të kësaj prone po ashtu është i përcaktuar në bazë të rregullores, pastaj për kritere dhe ofertat është i caktuar komisioni për dhënien në shfrytëzim të hapësirave të Komunës së Rahovecit.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, ne edhe në KPF e kemi shqyrtuar këtë pikë, ku e kam pyetur drejtorin se deri tani kjo sipërfaqe a ka qenë e shfrytëzuar nga dikush, përgjigja e drejtorit ka qenë jo, por sipas informatave që i kam në këtë vend ishte dikush i vendosur me mjete të punës, por kjo nuk është shumë me rëndësi. Prandaj ne si grup i PDK-së e kemi shqyrtuar këtë çështje dhe jemi pro këtij propozimi, sepse me anë të kësaj bëhet ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike, po ashtu bëhet punësimi i qytetarëve, shkurtë kjo është në dobi të qytetarëve të Komunës së Rahovecit. Kurse sa i përket afatit kohorë nëse pajtohen edhe kolegët e tjerë ndoshta kishte me qenë e mjaftueshme të jetë për periudhën dhjetë vite (10).

Fehmi Cena – Edhe ne si grupe i LDK-së e kemi shqyrtuar këtë pikë dhe jemi për dhënie në shfrytëzim të kësaj prone komunale personave fizik dhe juridik, sepse konsiderojë se dobia është e dy anshme. Kjo duhet

të bëhet përmes ankandit publik, ku pastaj do të caktohen kriteret e caktuara për ato firma ose bizneset të cilat i plotësojnë kushtet ose kriteret, sa i përket afatit kohorë edhe ne jemi pro që të jetë për 10 vite.

Dervish Çadraku – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, edhe ne përfaqësuesit e VV-së jemi pro këtij propozimi, madje mundet lirishtë të themi se kjo punë është vonuar sepse kjo punë ka shumë rëndësi për bizneset tona që ti shfrytëzojnë këto hapësira për të bërë biznes. Ne kemi informata që kjo nuk ka qenë në shfrytëzim deri tani, pyetje ime është pse nuk është marrë ndonjë iniciativë deri tani që ky objekt dhe kjo hapësirë të shfrytëzohet nga dikush dhe jo të mbetet kaq gjatë pa u shfrytëzuar. Pra pyetje ime është sa gjatë ka qenë kjo e pa shfrytëzuar, përndryshe edhe ne jemi dakord që kjo të jepet në shfrytëzim për 10 vite.

Ali Morina – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, edhe ne si grupe i AAK-së e mbështesim këtë propozim vendim dhe konsiderojmë se afati i propozuar nga z. Rasim Fazliu është optimal, prandaj jemi pro këtij afat prej 10 viteve.

Masar Popaj – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje për drejtorin, i nderuar a kemi të bëjmë me objekt apo sipërfaqe, pastaj nëse nuk ka objekt a do të ndërtoj komuna objektin apo do të ndërtoj vetë personi i cili e fiton ankandin, sepse sa e di unë një objekt në këtë vend ka filluar të ndërtohet pa pëlqimin e komunës, por pastaj është ndërprerë ndërtimi.

Artan Asllani – Të nderuar ju faleminderit për pyetjet e parashtruara, i nderuari z. Rasim Fazliu kjo hapësirë e jashtme nuk është shfrytëzuar asnjëherë, por nuk do të thotë që nëse nuk është shfrytëzuar asnjëherë ne mos ta qesim në ankand publik. Po ashtu ne nuk mundmi me e qitë në kuvend pa na ardhur kërkesat nga bizneset, tani aty janë disa biznese që vitin e kaluar kanë marrë grande nga Qeveria e Republikës së Kosovës, tani ju është mbetur inventari jashtë dhe nuk po kanë mundësi të zhvillojnë aktivitetin banesor. Tani na janë drejtuar me kërkesë për marrje me qira të kësaj parcele, prandaj ne ju kemi drejtuar tani juve dhe ju jeni ata që vendosni, po ashtu është e vërtetë se një biznes ka filluar që të ndërtoj një objekt në këtë parcelë, por si kemi marrë informacionin, inspektorati ka dalë në teren dhe ja ka ndërprerë punimet. I nderuari z. Fehmi. Cena sa i përket ankandit publik është komisioni i formuar nga kuvendi që vendos sa i përket kriterëve dhe kushteve që duhet të i plotësoj një biznes.

Munib Durguti – I nderuar drejtor ku gjendet ky objekt dhe sa është i madhe ky objekt, ne nuk kemi ndonjë orto foto, përkundër asaj që kanë qenë kërkesat në të kaluarën që kur të vendoset për pronë të jepet informacioni në hollësi. Pastaj ne këtu jemi të thirrur që të vendosim për një hapësirë prej 800 m², prandaj po ju rikujtoj se nuk ka mundësi të zhvillohet biznesi vetëm në një objekte nëse nuk përfshihet edhe hapësira e jashtme, ka mundësi që në një të ardhme të afërt të lindë edhe ndonjë konflikt mes operatorëve.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve për pyetjet e bërë, e qes në votim propozimin e z. Rasim Fazliu që kjo pronë të jepet për 10 vite: Konstatoj se unanimisht është votuar pro propozimit të z. Rasim Fazliu. Tani të nderuar e qes në votim Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës, për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik: Konstatoj se unanimisht është votuar pika e tretë (3) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozimit të Kryetarit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Artan Asllani – Drejtoria të cilën unë e drejtoj për këtë mbledhje ka përgatitur ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01 Nr.576 të datës 28.02.2017, konkretisht neni 23 të kësaj rregullore. Tabela sipas kodeve të zyrës së ARBK-së, si propozim janë gjithsej 6 kode, kodi 1102, 4711, 4721, 4724, 4751 dhe 4775. Po ashtu sa i përket ndryshimit të kësaj rregullore na ka ardhur edhe një propozim për ndryshimin e tasave nga Qendra për Punë Sociale në nenin 17.5. Arsyeja dhe qëllimi i këtyre ndryshimeve është që tu jepet përkrahja bizneseve të vogla të Komunës së Rahovecit, ne jemi të gjithë dëshmitar se bizneset e vogla të komunës sonë janë çdo ditë në shuarje, prandaj ne e kemi bërë këtë propozim për lirimin e tyre nga këto taksa komunale. Sipas raportit të përgatitur nga zyrtari për taksa, na dele se janë dikur rreth 1330 biznese që do të përfitojnë lirimin e kësaj takse dhe vlera vjetore në total kapë shifrën rreth 7,500.00 €. Kurse tek ndërmarrjet prodhuese sipas kësaj rregullore neni 23.4 ceket se

ndërmarrjet që i punësojnë mbi 5 punëtor janë të liruar për dy vite nga taksa, 10 punëtor lirohen për 3 vite, 20 punëtor për 4 vite e kështu me radhë.

Fehmi Hoxha – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, më vije shumë mirë që pas kërkesës që e bërë para dy mbledhjeve Drejtorit të Ekonomisë si subjekt i PDK-së që të lirohen nga taksa bizneset e Komunës së Rahovecit, edhe pse jam duke i parë disa biznese këtu në propozim që kanë qenë të liruara më herët, por besoj se drejtori na shpjegon. Por desha të ndërlidhem edhe me një kërkesë të cilën e kanë bërë dhjetë avokatë, ku ju kanë drejtuar Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ku kanë kërkuar që në plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, të lirohen edhe ata nga taksa vjetore. Të nderuar mbi 90% të komunave të Republikës së Kosovës e kanë liruar këtë kategori sepse edhe kjo llogaritet biznes, kjo kërkesë ka shkuar tek zyra e kryesuesit të kuvendit, por ata ju janë drejtuar Kuvendit të Komunës së Rahovecit. Kryesuesi ju ka kthyer një përgjigje negative atyre dhe besoj se ko është një gabim i madh, sepse kryesuesi nuk ka të drejtë një gjë të tillë të bëjë sepse ata ju janë drejtuar anëtarëve të kuvendit. Po ju them këtu publikisht që ata kanë dashur të ju bëjnë edhe kallëzim penal, por nuk i kam lejuar sepse ju kam thanë që është bërë një gabim teknik ose prej mos dijes. I nderuari kryesues kur një kërkesë i drejtohet kuvendit komunal atëherë ajo kërkesë duhet të vije tek ne, ju nuk keni të drejtë të i ktheni përgjigje. Prandaj i nderuari kryesues propozoj që për këtë mbledhje në këtë pikë të rendit të ditës të futet edhe propozimi imë për lirim nga taksa edhe veprimtaria e avokatëve të cilët veprojnë në komunën e Rahovecit.

Rasim Fazliu – I nderuari kryesues e kam ngritur shqetësim edhe në mbledhjen e KPF-së që janë duke ndodhur disa ndryshime të forta rreth taksave dhe tarifave, por ne sot duhet të vendosim si kuvend. E falënderoj kolegun që e dha një kontribut rreth propozimit për ndryshimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, do të ndalem tek tarifat e QPS-së. Më duke e pakuptimtë dhe pa arsyeshmëri që të na vinë tarifat kaq të ngritura tek sektori i QPS-së, p.sh taksa për vërtetimin për humbje të nënshtetësisë 5 € është për momentin, kurse propozimi është që të ritet në 20 €, por këto janë propozime por kuvendi është ai që vendos. Pastaj taksa vërtetimi i zotësisë së vapimit për punësim fillestar, mendoj se propozimi i dhënë është goxha i lartë sepse jemi dëshmitar të asaj se shumë pak kemi mendësi ne si komunë të punësojmë njerëz, dhe në një konkurse konkurrojnë deri në 50 aplikues dhe nga ta vetëm njëri pranohet, prandaj propozimi që taksa nga 5 € të ritet në 10 € është gabim, unë kisha propozu që kjo taksë të jetë më e vogël se 5 €, sepse sa herë që të përsëriten konkurset me nxjerrë këtë vërtetim është shumë keq. Do të dalë me propozime konkrete, prandaj ne si grup i PDK-së jemi pro asaj që tarifat për sektorin e QPS-së të jenë si në vijim: Taksa nga nr.5 e deri tek nr.10 është propozuar që të hiqet të bëhet zero edhe ne si grup i PDK-së pajtohemi, kurse taksat tjera të mbeten ashtu siç kanë qenë, po ashtu duke e bashkangjitur edhe propozimin paraprak që e bërë z. Fehmi Hoxha sa i përket taksës për avokatë.

Munib Durguti – Po ashtu edhe unë e mbështesë kërkesën e avokatëve dhe mendoj se është shumë e arsyeshme që të aprovohet kjo kërkesë edhe për një arsye shtesë, ngase ju kujtoj se nga viti 2010 -2011, kur janë bërë reforma në sistemin gjyqësor, me daljen e noterëve për herë të parë në Kosovë, shumë veprimtari të avokatëve kanë kaluar në fushë veprimtarin e noterëve.

Fehmi Cena – Është shumë e qartë që nga ne kërkohet që të bëhet plotësim ndryshimi i Rregullores për, taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, konkretisht në dy nene, neni 23 dhe neni 17.5. tek neni 23 i cili ka të bëjë me Drejtorin për Ekonomi dhe turizëm, ku kërkohet që të lirohen disa kategori të bizneseve nga taksat komunale, kryesisht kategori tregtare. Kurse në nenin 17.5 i cili ka të bëjë me kategorinë e QPS-së, kërkohet që të bëhet ndryshimi i disa tarifave për shërbime në këto institucione, shumica prej këtyre kërkohet që të ritet tarifat dhe disa nga at të largohen të gjitha. Ne si grupe i LDK-së mendojmë se është koha dhe momenti që bizneseve tona të i dilet në ndihmë përmes këtyre lirimeve, ne në KPF kemi kërkuar edhe disa sqarime shtesë të ne jepen sot këtu, ne kemi kërkuar saktë sa është numri i bizneseve që do të lirohen nga kjo taksë. Shuma të cilën e ceku drejtori që inkasohet nga këto biznese nuk na duket shumë reale, ne e kemi parasysh se buxheti i komunës do të dëmtohet gjithsesi nga mos inkasimi i këtyre të hyrave, por komuna dhe qeveria lokale ka për detyrë që të gjejë edhe forma të tjera që të kompensohet kjo pjesë e mos inkasimit. Po ashtu pajtohemi me propozimin e z. Fehmi Cena që kërkesa e avokatëve të jetë

pjesë e kësaj liste, pra që të lirohen nga taksa, është mirë që tu ndihmohet edhe këtyre në një formë për zhvillimin e bizneseve. Neni 17.5 tek pjesa e QPS-së, ne edhe në mbledhjen e KPF-së kemi pasur disa vërejtje në lidhje me disa ngritje që janë bërë në taksat e kësaj drejtorie, dhe këto vërejtje nuk janë mare parasysh, jemi duke i parë se edhe në këtë mbledhje na kanë ardhur ashtu siç kanë qenë në KPF. Jam i mendimit se këto janë kategori sociale dhe nuk duhet të bëhet ngjitje, ato që janë prezantuar që të hiqen jemi pro, kurse sa i përket atyre që janë prezantuar që të ngritën ne jemi kundër.

Ali Morina – Sa i përket këtij ndryshimi për Rregulloren për Taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, ne si grupe i AAK-së e mbështetnin këtë propozim, por vetëm taksa për vërtetimi i zotësisë së veprimit për punësim fillestar të mbetet ashtu siç ka qenë 5.00 €, kurse sa i përket pjesës tjetër jemi pro ashtu siç e ka propozuar drejtori.

Dervish Çadraku – Pjesërisht edhe unë pajtohem me disa propozime të parafolësve, por më duke si nga pak po i vije era e zgjedhjeve dhe jeni duke i hequr të gjitha këto taksa, në mënyrë që të dilni sa më mirë qytetarëve, por duhet të dini se këto taksa janë ato që i mbushin arkat e komunës, në mënyrë që pastaj qytetarët të kenë një mirëqenie sa më të mirë. Prandaj mendoj se kishte me qenë mirë që të jemi pak më real dhe më konkret, pra të i njohim gjërat për të cilat jemi duke biseduar këtu, ne po ashtu jemi dakord që avokatëve të i hiqen taksat por jeni duke parë propozimet për QPS-në që i kemi ngarkuar menjëherë me një peshë shumë të rëndë, kemi taksa që kanë që janë propozuar të ndryshohen nga 5.00 € në 20.00 €. Avokatët dhe disa kategori tjera që janë më mirë se kjo kategori që e përmenda më parë, prandaj unë jam i propozimit që këto kategori që janë propozuar për 20.00 € të jenë 10.00 €.

Sali Sallteku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, I nderuari kryesues sa e di është punësuar një lektore në komunë, dhe kishte me qenë mirë që të bëjë lektorimin e këtyre materialeve, sepse me të vërtet ka gabime shumë. Drejtori e tha se ne jemi duke i falë disa kategori të bizneseve që janë të vogla, nuk e besoj se janë të vogla kategoritë ose taksa për prodhimin verës që është 500.00 €, jam pro që të lirohen disa biznese, por jam pro propozimit të shefit të grupit, ato që janë propozuar që të hiqen le të hiqen, kurse ato që janë le të mbesin ashtu siç kanë qenë e jo të ritën, kjo do të jetë në dobi të qytetarëve.

Nënkryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne e kuptojmë se veç në një para fushat jemi, por ne nuk jemi evlia që të dimë se kur do të ndodhin zgjedhjet, ky propozim ka qenë edhe më herët nga Drejtoria për Ekonomi dhe zhvillim. Do të ndërlihem me një taksë sa i përket QPS-së, sa i përket taksës së Konstatimit për humbjen e shtetësisë, në MPB kjo taksë paguhet 150.00 €, kurse ne në komunë kemi bërë një ngritje prej 5.00 € në 20.00 €, pastaj taksa e vërtetimit që nuk ju është hequr zotësia e veprimit, ko është që të konstatojnë se a je i aftë për një punë apo jo, këtu ceket për armëmbajtje. Të nderuar për një provim për armëmbajtje duhet të paguash 200-300 €, pastaj për të blerë një armë duhet të paguash nga 800.00 € e më lartë, kurse ne e kemi propozuar taksën nga 5.00 € në 20.00 €, nëse ky person i ka deri në 2,000.00 € të i shpenzoj për leje të armëve dhe blerje, do ti ketë edhe 20.00 € të i paguaj komunës taksë. Ka mundësi disa taksa të mbeten ashtu siç është taksa vërtetim për punësim, por disa taksa me të vërtet kanë arsyetim të fortë pse duhet të ritën. Kurse sa i përket propozimeve për lirim të taksave tek Drejtoria e Ekonomisë, të nderuar ne e kemi bërë lirimin e taksave edhe më parë, në mandatin e kaluar kemi falë bukur shumë borxhe bizneseve. Ndërsa sa i përket kërkesës së fundit që e ngriti z. Hoxha për avokatë, sa e di unë në mandatin e kaluar sa kemi qenë na plotësim ndryshimi i Rregullores për taksa dhe tarifa është ngritur kjo taksë sepse kemi thënë se ata nga puna e tyre përfitojnë goxha shumë mjete, dhe në atë kohë ne kemi qenë të gjithë të pajtimit që kjo taksë të ngritet. Sa i përket kërkesave që i drejtohen kryesuesit të kuvendit ose kryetarit, pastaj përgjigja që ju është kthyer nga kryesuesi, i nderuar ata munden të ngrisin kallëzim penal, por në kërkesa kjo nuk lejohet, po ashtu përgjigja tjetër mundet të jetë e thjeshtë mundet me qenë inkopetencia, një organ i drejtohet një organi, kurse organi tjetër ka menduar që ti përgjigjet, pra thjeshtë është inkopetencia. Por ju jeni kuvendar dhe ju jeni ata që vendosni në fund që e aprovoni me votat e juaja, pra ju jeni organi i cili merë vendime përfundimtare.

Kryesuesi – Të nderuar e vë në votim një herë propozimin e z. Fehmi Hoxha, i cili propozoi që taksa për avokatë të hiqet dhe të jetë zero €: Konstatoj se me 16 vota për, 11 kundër dhe asnjë abstenim është

aprovuar kërkesa e z. Fehmi Hoxha. Tani të nderuar anëtar të kuvendit e vë në votim propozimin e Drejtorit të Ekonomisë sa i përket taksave që i takojnë drejtorisë së ekonomisë: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar plotësimi ndryshimi i taksave nga drejtoria e ekonomisë.

Kryesuesi – Të nderuar anëtar të kuvendit do të bëjmë 5 minuta pauzë, kjo bëhet me kërkesë të shefave të grupeve të cilët kërkojnë të diskutojnë sa i përket taksave për QPS-në.

Të nderuar kuvendar besoj se pas pauzës që e patët jeni konsultuar dhe keni ardhur me ndonjë propozim konkret sa i përket taksave për QPS-në.

Rasim Fazliu – I nderuari kryesues ne shefat e grupeve politike e mbajtëm një takim ku u pajtuam për të gjitha pikat një nga një, po ju lexoj një nga një tarifat e QPS-së në nenit 17.5. Po ju prezantoj me pika ashtu siç janë të renditura, propozimet tona janë këto: Pika 1 -10.00 €, pika 2 – 10.00 €, pika 3 – 20.00 €, pastaj kemi edhe dy nën pika të numrit tre, 3.1 – 5.00 €, 3.2 – 5.00 €, pika 4 – 10.00 €, pikat, 5,6,7,8,9 dhe 10, jemi pro propozimit të drejtorit i cili ka propozuar që të hiqen këto taksa dhe të jenë zero. Vazhdojmë me pikën e 11 – 5.00 €, pika 12 – 5.00 €, gjithashtu pika 13 – 5.00 €. I nderuar kryesues ky është qëndrimi i të gjitha grupeve politike rreth taksave të QPS-së.

Kryesuesi – Ju falënderoj për bashkëpunimin e treguar, tani të nderuar kuvendar e vë në votim Propozimin e Kryetarit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, kësaj i bashkëngjitet propozimi i z. Fehmi Hoxha: Konstatohet se unanimisht aprovuar pika e katërt (4) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

5. Informatë mbi implementimin e Planit për investime në hapësirat e hapura publike në Komunën e Rahovecit.

Përparim Krasniqi – Të nderuar kuvendar/e sa i përket hapësirave të lira publike apo implementimit të planit për investime publike, ne e kemi një kontratë e cila është e ndarë në tre pjesë e cila bënë mirëmbajtjen e këtyre hapësirave, e keni para vete edhe raportin ku janë të cekura edhe shënimet në detaje. Nuk do e zgjasja më shumë pasi e keni para vete informatë, nëse keni pyetje këtu jam për të ju përgjigjur.

Ali Morina – Ajo që më intereson të di është se a janë të përfshirë të gjitha hapësirat publike në të gjithë komunën e Rahovecit, flasë posaçërisht për fshatin Ratkoc sepse është një pjesë e cila është e rregulluar tek lumi por nuk ka kurrfarë mirëmbajtje. Kërkesa e banorëve të fshatit është që kompania e cila është e kontraktuar të bëjë mirëmbajtjen e kësaj hapësire, kam biseduar me udhëheqësit e kësaj kompanie, ata më kanë thënë nuk e kanë për detyrë të e mirëmbajnë këtë hapësirë, ka pasur raste kur ata me vetë dëshirë e kanë mirëmbajtur. Po ashtu është edhe një pjesë që ne e quajmë tek Bunari i madh, është një monument identifikues për fshatin tonë, ku një mërgimtare e jona me vetëfinancime ka rregulluar këtë vend, por aktualisht aty nuk ka mirëmbajtje, bari është pothuajse një metër, ulëset që janë aty po ashtu janë dëmtuar. Pyetje ime është a i keni vë në listën e mirëmbajtjes së hapësirave publike për vitin e ardhshëm apo jo.

Dërvish Çadraku – Falënderoj drejtorin për këto informata që na i ka sjellë, por unë kam disa vërejtje rreth kësaj informate sepse sipas meje këtë informate ju e keni bërë nga zyra, sepse disa gjëra nuk përputhen me ato që na i ke shkruar në këtë informatë. E marr shembull hyrjen në Rahovec nga Xërxa kur vije, tek rreth rrotullimi asnjë bimë nuk është e freskët, ne raste të tilla kemi sa të duash, prandaj është mirë që ata që e marrin detyrën për mirëmbajtje të këtyre hapësirave gjelbëruese të i mbikëqyrin këto hapësira, sepse nuk janë duke bërë punën mirë sa i takon mbijetesës së bimëve. Mendoj se duhet të bëhet një komision më ekspeditiv, po ashtu ka disa vende në komunën tonë të cilat duhen të rrafshohen, të hiqen barojat e mëdha që janë bërë dhe pastaj të mirëmbahen. Keni një ratë të mirë në fshatin Fortesë, kemi disa hapësira nuk e di a i mirëmbajnë vet banorët e fshatit apo kompania, sidoqoftë por është mirë që edhe në Malësi të Vogël, Ratkoc dhe fshatrat e tjerë të i keni nën mbikëqyrje sepse me të vërtetë është si në xhungël. Pastaj kishte me qenë mirë që të formohet një komision ose nga ju si drejtori ose nga kuvendi, komision për vetëdijesimin e qytetarëve, ky komision të shkojë nëpër shkollat të mbajë ligjëratat për vetëdijesim ku të ju shpjegohet fëmijëve se mbeturinat nuk duhet hedhë rrugëve. Po ashtu duhet të vendosen më shumë në ato pjesë ku ka më shumë qarkullim të fëmijëve, prandaj mendoj se ka ardhur koha që të kemi veprime konkrete.

Trajko Shqariq – Ato që desha të them shumicën i tha parafolësi, është e vërtetë që ka disa vende që nuk ngjajnë fare në hapësira të gjelbëruara, ka shumë nevojë për mirëmbajtje, po ashtu pajtohem edhe me propozimin që e dhe i nderuari z. Çadraku që të punohet më shumë rreth ngjitjes së vetëdijes së qytetarëve që mos të hedhin mbeturina vend e pa vend, po ashtu duhet të mësohemi që të mirëmbajmë edhe vetë ato hapësira të gjelbëruara.

Fehmi Cena – E përshëndesim Drejtorin e Shërbimeve Publike i cili na ka sjellë informatën për mbi implementimin e planit për investime në hapësirat publike, e kemi parë që plani është 5 vjeçar, po ashtu e kemi kuptuar se ka pasur rritje të sipërfaqeve për mirëmbajtje, por po ashtu është rritur edhe pagesa rreth mirëmbajtjes. Ne edhe si kuvendar por edhe si qytetar kërkojmë që të rritet përgjegjësia e këtyre operatorëve ekonomik në mirëmbajtjen e këtyre hapësirave, ne shumë shpesh kemi pasur edhe vërejtje konkrete sa i përket hapësirave publike në këtë sallë sepse operatorët nuk janë kujdesur aq sa duhet. Shembull konkret për mos mirëmbajtje janë varrezat, në ato vende ku është bari po mirëmbahet, kurse në ato vende ku janë rritur tharat ku pastaj ato bëhen kaçube askush nuk po ndërhyrë. Të nderuar mirëmbajtje do të thotë të i asgjësosh të gjitha a jo vetëm barin. Sa i përket drunjtëve dekorativ që janë mbjellë skaj rrugës ne e kemi përkrah këtë projekt, por nëse ndalemi tani të i shohim këto drunjtë dekorativ, do të shohësh se ato janë në një gjendje të mjerueshme, një pjesë e madhe e tyre janë tharë. Në të kaluarën e kam bërë një pyetje ku e kam pyetur drejtorin a është në kontratë edhe mirëmbajtja e tyre apo vetëm mbjellja, nga drejtori kam marrë përgjigje se ata 2-3 vite kompania e ka marrë përsipër mirëmbajtjen e tyre, kurse në realitet këto drunjtë nuk janë duke u mirëmbajtur sepse janë duke u tharë.

Ali Zhuniqi – desha të ndërlidhem rreth diskutimit të z. Dervish Çadrasku, i nderuar hapësirat publike në fshatin Fortesë mirëmbahen kryesisht nga banorët e këtij fshati, por ajo që kam kërkuar unë nga drejtori i shërbimeve publike është që të bëhet pastrimi i lumit i cili përçon fshatin Fortesë. Një pjesë e kanalizimit është bllokuar dhe si rrjedhojë e kësaj një pjesë e kanalizimit derdhet në lumë dhe kjo pastaj e bënë edhe ndotjen e ambientit, ku kundërmon erë dhe shkakton goxha problem për banorët të cilët jetojnë përreth kësaj pjese.

Masar Popaj – I nderuari kryesues desha të ndërlidhem tek lotot që janë të cekura këtu në këtë informatë shkruan Loto 1 - 16,709.28 €, loto 2 – 21,359.06 dhe loto 3 – 15,233.76 €, vlera totale është 53,302.16 €. I nderuar këtu vlera nuk është e saktë, është bërë një gabim teknik dhe ky gabim duhet përmirësuar sepse ky është një dokument zyrtar, sepse sipas llogarisë sime nëse i mbledhim shumën e këtyre tre lotove do na dele në fund shuma 53,302.10 €.

Rasim Fazliu – E falënderoj drejtorin që na ka sjellë këtë informatë, këtu janë të cekura disa të dhëna konkrete, tek pika 2 ceket: Mirëmbajtjen e ambienteve të ndërtuara, sheshe, i nderuar duhet të jetë shesheve, shtigjeve për këmbësor dhe sipërfaqe të shtruara. Pastaj tek pika nr.3 shkruan: Mirëmbajtje të hapësirave për parkim automjesh, i nderuar edhe këtu mendoj se duhet të jetë mirëmbajtje e hapësirave publike për parkimin e automjeteve. I nderuar është mirë që të përmirësohen këto gabime drejtshkrimore. Kurse sa i përket rezultateve është e vërtetë që shihen disa hapësira të mirëmbajtura, ku janë mbjellë disa drunjtë dekorativ dhe me këtë duhet të jemi të kënaqur edhe ne si anëtar të kuvendit komunal. Por ajo që dua të them është se kanë mbetur edhe disa vendbanime tjera pa këto drunjtë dekorativ, prandaj është mirë që të vazhdohet me mbjelljen e këtyre drunjtëve. Sipërfaqet e gjelbëruara mirë që janë duke u mbikëqyrur, por pajtohem me disa koleg që thanë se janë disa mjedise të cilat ndodhen në mes të fshatrave, konkretisht në fshatin Celinë, jashtë oborrit së shkollës është një hapësirë goxha e madhe e cila nuk është aspak e mirëmbajtur. Kishte me qenë mirë në këtë pjesë që e ceka të bëhet së pari rrafshimi i dheut, dhe të hiqen ato baroja dhe me këtë do të krijohej një hapësirë e gjelbëruar. Ajo që më ka lënë përshtypje tek kjo informatë është se ju e thatë që para se të filloj projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike, kontratat e komunës së Rahovecit kanë qenë të identifikuara në masë jo të duhur, por ë vitin 2018 kjo ka ndryshuar. Kjo është shumë në rregull sepse vite pas viti duhet të ndryshohen gjërat, por ndoshta kësaj informate është dashur të shtohet që qeverisja e kaluar nën udhëheqjen e z. Idriz Vehapi, ka qenë një qeverisje transparente, me një performancë të mirë, ju vetë jeni në dijeni sepse keni qenë anëtar i kuvendit, komuna jonë e ka zënë vendin

e tretë për përmirësimin e shërbimeve publike, ku DEMOSI e ka shpërblyer me mjete të caktuar. Në vitin 2018 kur ju keni ardhur në qeverisje i keni trashëguar këto mjete, ku më pas me ato mjete ju keni punuar. Kurse kur vijmë tek lotot, mendoj se është ndarë goxha një shumë e mirë, prandaj mendoj se me këto shuma ka mundësi edhe ato hapësira që i cekëm ne që nuk janë duke u mirëmbajtur të mirëmbahen. Pajtohem e mate që e tha z. Ali Zhuniqi sepse në Fortesë kur kalojmë të gjithëve na lënë përshtypje se si mirëmbahen hapësirat e gjelbëruara, pra banorët e këtej fshati janë vetëdijesuar që duhet të mirëmbahen vendet e hapura publike, prandaj rreth kësaj duhet punohet më tepër si ne ashtu edhe qeverisja lokale.

Afërdita Thaqi – Do ndërlidhem me diskutimin e z. Rasim Fazliu, e vërejta se ai disa herë i potencoi gabimet drejtshkrimore që janë duke bërë në materialet e mbledhjes së kuvendit, të gaboje dikush nga ne është diçka tjetër, por të gaboje kuvendi komunal është diçka e madhe. Sa jam e informuar unë ju e keni punësuar një lektore, a është duke e kryer ajo punën e saj apo jo, siç po duke edhe me atë nuk është diçka në rregull.

Kryesuesi – E nderuar ajo është duke e kryer punën e saj me shumë përkushtim, por ajo ka bukur shumë ngarkesë, të gjithë këtë material që ne e kemi sot këtu ajo duhet ta lekturojë.

Refli Kryeziu – Sa i përket mirëmbajtjes së hapësirave publike në mes të fshatit Xërxë gjendet një hapësirë publike, por asnjë herë nuk është pastruar nga kompania përgjegjëse, prandaj kishte me qenë mirë që edhe kjo hapësirë të përfshihet në mirëmbajtje.

Rukije Krasniqi – Do të ndalem tek synimet dhe objektivat, mendoj se synimi dhe objektivi duhet të jenë hapësirat publike shkollore, si dhe institucionet tjera komunale sepse duhet të jemi shembull qytetar të cilët munden të reflektojnë tek familjarët e tyre. Hapësirat e gjelbëruara dhe pemët dekorative ndikojnë shumë pozitivisht, e sidomos në shkollë, është një relaksim për fëmijët dhe mësuesit po ashtu kjo ndikon pozitivisht në mirëqenien e tyre.

Fehmi Hoxha – I nderuari drejtor tek synimet keni bërë një krahasim ku keni cekur se deri në vitin 2016 janë investuar rreth 25,000.00 € në mirëmbajtjen e hapësirave publike, por pyetje ime për ju është sa mjete janë ndarë në vitin 2017 për mirëmbajtje të hapësirave publike, po ju them unë në vitin 2017 janë ndarë afro 39,000.00 €. Prandaj duhesh të cekës për çdo vit se sa kanë qenë mjetet e ndara për këtë kategori, uroj që të mbërrij edhe më shumë se 150,000.00 € për këtë kategori, sepse shumë është me rëndësi që të mirëmbahen hapësirat publike. Po ashtu do të ndërlidhem me diskutimin e znj. Rukije Krasniqi, sa i përket krijimit të hapësirave publike në shkollë, e nderuar DKA-ja e ka grandin specifik, ata duhet të parashohin në kuadër të investimeve kapitale edhe mirëmbajtjen e hapësirave të brendshme ose oborreve të shkollave.

Përparim Krasniqi – Të nderuar ju falënderoj për pyetjet e bëra, ne jemi duke u munduar që të ja dalim mirë me ambientin, komuna e Rahovecit është përfituese e grandit të performancës në këtë aspekt. Sa i përket gabimeve drejtshkrimore të nderuar ne në Planin për Investime Publike i cili është aprovuar po nga ky kuvend është aprovuar me këto gabime drejtshkrimore, këtë plan nuk e kemi bërë ne por e ka bërë DEMOSI, dhe ne të gjitha shënimet i kemi marrë po nga ky plan. I nderuari z. Ali Morina është e vërtetë që ka qenë në kontratë për pastrim dhe një herë është bërë, por siç e dini këtë vit kemi pasur të reshura të shumta dhe nuk kemi pasur mundësi të bëjmë pastrimin e këtij lumi. I nderuar z. Dervish Çadraku mund të ju them lirishtë se është hera e dhjetë që po ndërhyrë në atë rreth rrotullim në hyrje të Rahovecit, por ndoshta është e vërtetë që nuk janë ujitur ato lule aq sa duhet për të mbijetuar. Ne e kemi pasur një rast tek rreth rrotullimi te pompa Shell në hyrje të Suharekës, aty e ka marrë përsipër që të mirëmbaj, por fatkeqësisht nuk e ka mirëmbajtur dhe janë tharë ato drunjtë dekorativ. Por ne në vitin e ardhshëm do të identifikojmë këtë si problem dhe do të fusim në listën e mirëmbajtjes nga komuna. shumë pyetje janë bërë të njëjta, sa i përket mirëmbajtjes së varrezave është vërtetë që duhet të ritën edhe monitoruesit që i përcjellin këto punime dhe mos të lejohen të mbetet diçka pa u pastruar në pjesën e varrezave. Po ashtu është e vërtetë që pjesa e Fortesës është marrë edhe si model në krahasim me vendbanimet e tjera, sepse banorët e këtij lokaliteti hapësira e cila gjendet në rrugën kryesore të fshatit e mirëmbajnë vetë, kurse pjesët tjera si varrezat civile, pjesët e tjera të lapidarëve, varrezat e dëshmorëve që janë në kuadër të kontratave këto i mirëmban komuna vazhdimisht. I nderuar z. Rasim Fazliu ne këtë vit jemi në fazën e kontraktimit të kontratës së dytë sa përket

10000 drunjtëve dekorativ, pra ato vendbanime që nuk janë mbuluar me kontratën e parë do të mbulohen tani me këtë kontratë. Sa i përket propozimit që e dha e nderuara znj. Rukije Krasniqi, e nderuar hapësirat e lira publike të cilat gjenden brenda institucioneve nuk përfshihen në këtë kontratë, si p.sh oborret e QKMF-ve, të shkollave, të shtëpive të kulturës etj. pastaj komuna e Rahovecit kufizohet me shumë rrugë rajonale, këto rrugë i menaxhon ministria dhe ajo i kontraktton për mirëmbajtje, fatkeqësisht këtë vite vetëm një herë është bërë mirëmbajtja. Ne tani e kemi formuar një komision ku i kemi identifikuar zonat të cilat nuk kanë qenë pjesë e kontratës, prandaj vitin e ardhshëm ndoshta do të ritet vlera pak sepse, këtë vite do të ndërtohen disa parqe, po ashtu pastaj ato duhet të mirëmbahen. Kurse sa i përket propozimeve të z. Dervish Çadraku, i nderuar nëse dëshironi që kuvendi ta ketë nga një përfaqësues në këtë komision s ai përket vetëdijesimit të qytetarëve rreth hedhjes së mbeturina, por ndoshta duhet të bëhet një projekt se si do të duket kjo formë e prezantimit, a do të ketë kjo ndonjë kosto financiare apo jo, a do kemi vullnetar në këtë komision, pra janë disa teme që duhet të shtjellohen. I nderuari z. Fehmi Cena në kuadër të kontratave është i planifikuar edhe sigurimi i kontratës dhe drunjtëve nëse thahen, kompania e cila i ka vendos duhet që ti zëvendësoj, pra ata e kanë një periudhë të caktuar të sigurimit.

Ali Zhuniqi – Sa i përket vetëdijesimit, kjo duhet të shkojë në kuadër të Drejtorisë për Rini, kulturë, rini dhe sport sepse shumica e të rinjve e kanë vëmendjen tek kjo drejtori. Ne kemi parë që Drejtoresha e Kulturës së bashku me kryetarin e komunës e kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi 5 vjeçar me njërin nga organizatat, zakonisht vetëdijesimet e të rinjve zakonisht bëhen përmes OJQ-ve, prandaj ne duhet të u japim OJQ-ve një fond dhe ata të mbajnë nëpër shkolla ligjërata përkatëse për vetëdijesimin e nxënësve.

Vahid Krasniqi – I nderuari drejtor në fshatin Drenovcë mbi 80% të drunjtëve dekorativ janë tharë, a e keni bërë ndonjë kërkesë për zëvendësimin e tyre.

Përparim Krasniqi – I nderuar sa i përket drunjtëve dekorativ kjo është përgjegjësi e Drejtorisë së Urbanizmit, por sa për informatë në momentin që thahen drunjtë duhet të lajmërohet kompania dhe ajo pastaj të bëjë zëvendësimin me drunjtë e ri.

Kryesuesi – Të nderuar ju falënderoj shumë për kontributin e dhënë sa i përket Planit për investime në hapësirat e hapura publike në Komunën e Rahovecit, po ashtu falënderoj edhe drejtorin për përgjigjet e dhëna. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

6. Rishqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores Komunale për Transparencë Komunale 2019.

Haziz Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar kjo rregullore na është kthyer nga MAPL-ja për rishqyrtim, për arsye se është dashur të bëhet harmonizimi me udhëzimin administrativ 04/2018 dhe me rregulloren për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve komunale 01/2017. Përmirësimi është bërë në faqe nr.3 neni 4 pika 4.6, faqe nr. 5 neni 6 pika 6.9 dhe faqe nr.9 neni 18 pika 18.1 dhe 18.2. pra këto janë ndryshimet që janë kërkuar nga MAPL-ja.

Kryesuesi – Të nderuar e vë në votim Draft – Rregulloren Komunale për Transparencë Komunale 2019: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e gjashtë (6) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të komunës për nisëm e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim midis Komunës së Rahovecit dhe Komunës së Frascineto.

A ka dikush të shtoj diçka sa i përket kësaj pika, nëse jo e vë në votim Propozim Vendimin e Kryetarit të komunës për nisëm e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim midis Komunës së Rahovecit dhe Komunës së Frascineto: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e shtatë (7) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të komunës për nisëm e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim midis Komunës së Rahovecit dhe Komunës së Civita.

A ka dikush të shtoj diçka sa i rreth pikës së fundit, nëse jo e vë në votim Propozim Vendimin e Kryetarit të komunës për nisëm e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim midis Komunës së Rahovecit dhe Komunës së Civita: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tetë (8) e rendit të ditës.

Kuvendar të nderuar ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirupafshim në mbledhjet e radhës!
Mbledhja e Kuvendit ka përfunduar në ora 14:40

01 Nr. _____
Rahovec, 26.09.2019

Procesmbajtësi:

Skender Hamza

K R Y E S U E S I

Afrim Dina



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të dispozitave të neneve 12, 17, 24 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), Dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 2, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2, nenit 39, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në Mbledhjen e mbajtur me datë 26.09.2019 merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Rahovecit për vitin 2020-2022

1. **Miratohet** vendimi për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB-i) për Komunën e Rahovecit për vitin 2020-2022.
2. Shtojcë e këtij vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2020-2022 dhe lista e projekteve kapitale për vitin 2020.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Rahovecit.
4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01-Nr-_____
Me datë: 26.09.2019

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit / Opština Oraovac / Municipality of Rahovec

**KORNIZA AFATMESME
BUXHETORE (KAB)
E KOMUNËS SË RAHOVECIT
2020-2022**

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

2019

Përmbajtja:


Përmbajtja:.....	1
I. Hyrje.....	2
II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme.....	3
1. Forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë përmes:.....	4
2. Forcimi i Sektorit të Bujqësisë	4
3. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe rritja e cilësisë në arsim.....	5
4. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve.....	5
5. Përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit, planifikimi urban dhe shërbimet publike komunale.....	6
6. Përcaktim i përhershëm i yni është:.....	6
7. Rinia, kultura dhe sporti	7
III. Korniza Fiskale Komunale.....	7
3.1 Indikatorët ekonomik komunal.....	7
3.2 Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afatmesëm 2020-2022	8
3.3 Tendanca e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2020-2022.....	12
3.4 Analiza Gjimore	19

I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore KAB që po prezantojmë është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu KAB siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen e objektivave prioritare, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritetit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2020/2022-1, të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Ky dokument do të jetë bazë për përcaktimin e sektorëve prioritar të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2020-2022. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:





III

Publikimi i Dokumentit të KAB-it 2020-2022

Fundi i Qershorit



IV

Procesi vjetor i buxhetit 2020

II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme

Komuna e Rahovecit gjendet në pjesën jugore të Kosovës, në rajonin e Dukagjinit (gjegjësisht në subrajonin e Anadrinit). Është njëra nga komunat e mesme me popullsi, pozita gjeografike që i mundëson asaj lidhje të mira me qendra të tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Rahovecit ka gjithsej 33 fshatra dhe 2 vendbanime, dhe një qendër urbane e ndarë në 5 lagje, me një popullsi prej 56,208 banorë, sipas regjistrimit të vitit 2011, e organizuar në 8.028 ekonomi familjare.

Mbi 3684 biznese operojnë brenda komunës sonë, bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në komunën e Rahovecit, afërsisht gjysma e tyre (50%) merren me veprimtari tregtare, 15% në sektorin e shërbimeve, rreth 16% në prodhimtari, 19% me transport etj.

Administrata e komunës së Rahovecit është e organizuar përmes zyrave qendrore dhe zyrave lokale që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, nga të cilat një është e vendosur në ndërtesën administrative të komunës dhe 8 të tjera në fshatra.

Vizioni i mëposhtëm për komunën e Rahovecit, i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike, ekonomike e sociale në komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjatë strategjike, që ka zhvilluar komuna, siç janë: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2020-2022 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe në

Qarkoret Buxhetore Komunale 2020-2022 (I & II), të lëshuar nga Ministria e Financave e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Për tri vitet e ardhshme, vizioni i komunës së Rahovecit është: *të jetë qendër e zhvillimit ekonomik, me një bujqësi të zhvilluar, infrastrukturë të rregulluar, me plane zhvillimore dhe urbane, shërbime shëndetësore efikase dhe cilësore, komunë e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, e afirmuar si një qendër e kulturës, arsimit dhe jetës sportive. Poashtu, një komunë e zhvilluar, e fortë dhe me shërbime publike, administrative që ofrojnë cilësi të mirë të jetesës për të gjithë qytetarët e saj.*

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë, së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti, llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attributeve të ndërlidhura njëra me tjetrën, prioritetet strategjike të komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në pesë, e që do të mundësojnë realizimin e qëllimit e të vizionit tonë për komunën.

Këto prioritete janë:

1. Forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë përmes:

- Krijimit të zonave ekonomike dhe hapësirave për zhvillim.
- Lehtësira në të bërit biznes.
- Mbështetja direkte dhe indirekte e bizneseve.
- Mbështetja e turizmit dhe agroturizmit.
- Rritja dhe modernizimi i tregjeve
- Këshilla dhe sugjerime në të bërit biznes
- Investime në infrastrukturë publike, në zona potenciale për zhvillim ekonomik.

2. Forcimi i Sektorit të Bujqësisë

Zhvillimi dhe fuqizimi i sektorit të bujqësisë për të rritur bazën ekonomike dhe sociale në komunën tonë.

- Përkrahje bujqve dhe fermerëve me mekanizëm bujqësor, duke i klasifikuar për secilin sektor si:
 - a) Perimekulturë dhe Pemëtari - Mekanizëm bujqësor (kultivator të vegjël, spërkatëse, frezë, pllug, etj.)
 - b) Përkrahje me serra me sipërfaqe deri në 3 ari, 5 ari, 7 ari e deri në 10 ari,
- Përkrahje fermerëve me farëra, pleh kimik, pajisje bujqësore dhe me inpute bujqësore,
- Sektori i blegtorisë - përkrahje në makina mjelëse, stalla dhe ferma të vogla,
- Sektori i bletarisë - koshere për bletë, pajisje për trajtim dhe ruajtje të mjaltit etj.,
- Sektori i vreshtarisë - inventar për trajtim të rrushit pas vjeljes,
- Sektori i verëtarisë- pajisje për prodhuesit dhe inventar.

Një theks i veçantë për këtë sektor do të bie në: këshillime dhe hartim të projekteve për fermerët, në sigurim të tregut për fermerë etj.

- Fuqizimi i qendrave grumbulluese dhe përpunuese të pemëve dhe perimeve,
- Fuqizimi dhe përkrahja e bodrumeve për përpunimin e rrushit,
- Hapjen e tregjeve të reja në lokalitete të komunës sonë si: funksionalizim i tregjeve në Krushë të Madhe, Ratkoc, kushte më të mira në tregun ekzistues në Xërxë, ndërtimin e 2 tregjeve të reja në qytetin e Rahovecit, poashtu vazhdimin e fazës së dytë të projektit "Infrastruktura e tregut të rrushit" - te Shtëpia e Verës
- Fuqizimi i qendrave grumbulluese të qumështit, stimulimi i tyre.

Prioritetet i kemi edhe në:

- Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve fushore.
- Ndërtimin e kanaleve të kullimit në zonat ku paraqiten vërshimet
- Krijimin e fondit për Emergjencë etj.

Në sektorin e pylltarisë, do t'i jepet prioritet pyllëzimit të hapësirave të reja në tërë territorin e komunës. Toka e cila është nën menaxhim të Agjensionit Pyjor të Kosovës (APK) do të trajtohet me shumë kujdes dhe nuk do të lejohet degradimi dhe keqpërdorimi i saj.

3. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe rritja e cilësisë në arsim

- Investime në përmirësimin e kushteve infrastrukturore të shkollave në funksion të rritjes së cilësisë në arsim dhe ndërtimi i shkollave të reja.
- Eficienca e energjisë në shkolla, sipas nevojave.
- Investime në mjete konkretizimi, laboratorë, teknologji informative dhe furnizime të bibliotekave shkollore me libra.
- Funksionalizimi i përhershëm dhe bashkëveprimi i organeve drejtuese të shkollave, Këshillave Drejtuese të Shkollave, Këshillave të Prindërve dhe Këshillave të Nxënësve.
- Angazhimi i shërbimeve profesionale pedagogjike dhe psikologjike në shkolla.
- Angazhimi në ofrimin e trajnimeve profesionale të mësimeve në funksion të rritjes së cilësisë në arsim.
- Ndërtimi i çerdheve për fëmijë.

4. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

- Riorganizimi i QKMF-së, për më shumë funksionalitet.
- Subvencionim për rastet e sëmundjeve për personat pa të ardhura/të ardhura të ulëta.
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile.
- Ndërtimi i qendrave të reja shëndetësore etj.
- Krijimi i kushteve më të mira për stafin shëndetësor.
- Kujdesi paliativ, kujdesi shtëpiak.
- Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe jo ngjitëse.
- Parandalimi i sjelljeve të këqija si: droga, duhani dhe alkooli.

- Ofrimi i shërbimeve për të gjithë qytetarët në mënyre të barabartë.
- Shtimi i personelit shëndetësor.
- Vizitat sistematike shëndetësore të nxënësve në shkolla.
- Rritja e shërbimeve laboratorike (shtimi i llojeve të analizave në QKMF).
- Rritja e shërbimeve specialistike në QKMF - këshilldhënëse.
- Rehabilitimi i pacientëve me sëmundje mentale dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre.

5. Përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit, planifikimi urban dhe shërbimet publike komunale

- Ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve.
- Përmirësimi dhe rigjenerimi i infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriçimi publik, mirëmbajtja dhe numerizimi).
- Krijimi i shesheve të reja, parkingjeve dhe mirëmbajtja e tyre.
- Kolektori dhe impianti për trajtimin e ujërave të zeza.
- Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit.
- Eficienca e energjisë në objekte të sektorit publik.
- Menagjimi i integruar i mbeturinave dhe riciklimi i tyre.
- Hartimi i planeve zhvillimore dhe urbane, hartimi i projekteve të tjera dhe mbikëqyrja e punimeve.
- Përkushtim dhe mirëmbajtje ndaj komplekseve përkujtimore, shtatoreve, varrezave dhe busteve të dëshmorëve, varrezave të martirëve dhe atyre civile.
- Përmirësimi i standardeve mjedisore.
- Përmirësimi dhe zgjerimi i ujit të pijshëm.
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara dhe mirëmbajtja e tyre.
- Përmirësimi i gjendjes së lumenjve dhe përrenjve dhe trajtimi i shtretërve të tyre.
- Përkushtim ndaj të pastrehëve dhe familjeve në nevojë.
- Mbjellja e më shumë drunjëve dekorativ dhe mirëmbajtja.

6. Përcaktim i përhershëm i yni është:

- Qeverisje komunale e cila ofron shërbime efikase dhe që ju përgjigjet kërkesave të qytetarëve.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ndaj qytetarëve.
- Qasja sa më e afërt dhe e lehtë e qytetarëve në administratë.
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e zyrave komunale/gjendjes civile.
- Zgjerimi i sporteleve në zyrat e gjendjes civile.
- Sistemimi i zyrtarëve të zyrës së pranimit, kadastrës dhe arka, në një hapësirë të përbashkët, që kanë për qëllim shkurtimin e kohës për palët.
- Funkcionalizimi i sporteleve të veçanta për mërgatën.
- Vendosja e E-Kiosk –ut për shërbimet e shpejta dhe efikase për palë.

7. Rinia, kultura dhe sporti

- Mbështetja e sektorit të rinisë dhe kulturës (përkrahja e grupeve dhe OJQ-ve të ndryshme).
- Krijimi i rrjetit të OJQ-ve dhe mbështetje për to.
- Funksionalizimi i kuvendit të të rinjve dhe mbështetje e tij.
- Krijimi i Teatrit të Qytetit.
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë.
- Intervenimi dhe restaurimi në monumentet kulturo-historike dhe mirëmbajtja e tyre.
- Pasurimi i fondit librar në bibliotekat e komunës sonë.
- Trajtimi dhe mirëmbajtja e palestrave të sporteve, fushave sportive dhe ndërtimi i terreneve të reja sportive.
- Ngritja dhe mbështetja e të gjitha klubeve sportive etj.

III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Indikatorët ekonomik komunal

Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën 1. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2019-2021 të përpiluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Komponentët e politikës makroekonomike siç janë: Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2020-2022 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2020-2022 ku parashihet një rritje reale vjetore, 4.78 % në vitin 2020, ndërsa rritja reale e Bruto Produktit të Vendi në 2020 - 2022 parashihet të jetë 4.81%, respektivisht 5.14%.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në komunë, që në periudhën afatmesme ulet me 1.6 %, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshin: **1. Të hyrat vetanake dhe 2. Grandet qeveritare.** Komunitat po ashtu janë pranuese të granteve të donatorëve të jashtëm dhe të brendshëm (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna Rahovecit në periudhën afatmesme buxhetore 2020-2022, nëse krijohen rrethanat, planifikon të marrë hua nga institucionet financiare për të financuar projektet e saj në projektet për menaxhimin e

ujërave të zeza, për të cilën hua garantuese do të jetë Qeveria e Republikës së Kosovës, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

Tabela 1: Indikatorët ekonomik komunal


Përshkrimi	2019	2020	2021 (vlerësimet)	2022 (vlerësimet)
Indikatorët makroekonomik në Kosovë				
Rritja reale e BPV në %	4.7	4.70	4.51	4.64
Inflacioni në %	1.7	1.40	1.31	1.31
BPV për kokë banori, në euro	7.123	7.520	7.946	8.389
Indikatorët ekonomik komunal				
Popullsia e Komunës	56.208	56.208	56.208	56.208
Numri i bizneseve të regjistruara	2450	3684	3780	3800
Numri i nxënësve	10.841	10.312	10.312	10.312

Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qeveria e Kosovës, 2020-2022

3.2 Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afatmesëm 2020-2022

Të hyrat e Komunës së Rahovecit nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Figura 1: Buxheti Total i Komunës në vitet (2020 – 2022), milion Euro:



Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2020 grandet qeveritare për komunën e Rahovecit si tërësi do të shënojnë rritje prej 7.31%. Rritje e grandeve qeveritare do të jetë përafërsisht 7.31% në vitin 2020 në krahasim me 2019, ndërsa në krahasim me vitin 2019-2022 kemi rritje prej 14.92% sipas të dhënave të prezantuara në tabelën më poshtë, kjo rritje kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore që planifikohet në nivel të Qeverisë Nacionale, siç parashihet me KASH-in 2020-2022.

Të hyrat vetanake komunale, kanë shënuar zvoglim (rënie) për -1.03% nga viti 2019. Kjo përqindje e zvogëlimit e të hyrave vetanake është rezultat, se të hyrat nga gjobat e gjykatave dhe gjobat e trafikut tani e tutje do të planifikohen nga niveli qendror, përkatësisht nga Ministria e Punëve të Brendshme e jo nga komunat. Realisht nese shikojmë planifikimin nga viti 2020 deri në vitin 2022 rritja e të hyrave vetanake të planifikuara do të jetë 13.64%.

Tabela 2: Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2019-2022, në Euro

Burimi i të hyrave	2019	2020	2021	2022
Totali i buxhetit	13,658,895.00	14,735,819.00	15,254,801.00	15,821,735.00
Granti qeveritar	12,321,510.00	13,578,978.00	14,006,659.00	14,482,246.00
Granti i përgjithshëm	5,231,296.00	5,843,393.00	6,166,381.00	6,534,106.00
Granti i Shëndetësisë	1,686,240.00	1,889,703.00	1,965,291.00	2,043,903.00
Granti i Arsimit	5,380,480.00	5,820,978.00	5,850,083.00	5,879,333.00
Huamarrja në Arsim	33,719.00	-		
Këshilli i Hoçës së Madhe	23,494.00	24,904.00	24,904.00	24,904.00
Huamarrja në Shëndetësi	134,899.00	-		
Të hyrat vetanake	1,168,767.00	1,156,841.00	1,248,142.00	1,339,489.00
Buxhet dhe Financa	425,767.00	626,673.00	714,303.00	802,285.00
Tatimi në Pronë	310,000.00	390,333.00	402,043.00	414,105.00
Tatimi në Tokë	78,767.00	150,840.00	226,260.00	301,680.00
Taksa tjera administrative	2,000.00	500.00	500.00	500.00
Taksat rrugore	35,000.00	85,000.00	85,500.00	86,000.00
Administrata dhe Personeli	84,500.00	97,568.00	97,650.00	98,020.00
Taksa Çertifikatat e lindjes	45,000.00	72,500.00	72,500.00	72,700.00
Taksa Çertifikatat e kurorëzimit	14,000.00	3,500.00	3,550.00	3,600.00
Taksa Çertifikatat e vdekjes	4,500.00	1,200.00	1,250.00	1,300.00
Taksa Çertifikatat tjera ofiqarie	18,000.00	1,168.00	1,200.00	1,200.00
Taksa tjera administrative	3,000.00	19,000.00	19,050.00	19,100.00
Takse per pjesemarrje ne tender	-	200.00	100.00	120.00
Ekonomia dhe Zhvillim	130,500.00	163,600.00	163,300.00	163,800.00
Licenca te lira individuale	-	900.00	100.00	100.00
Licenca tjera per afazrem	-	100.00	100.00	100.00
Takse për ushtrimin e veprimtarisë	75,000.00	87,500.00	88,000.00	88,500.00
Qiraja nga objektet publike	55,000.00	75,000.00	75,000.00	75,000.00
Taksa tjera administrative	500.00	100.00	100.00	100.00
Kulturë, Rini, Sport	4,000.00	3,800.00	3,850.00	4,300.00
Shitja e sherbimeve(Bibloteka)	4,000.00	3,800.00	3,850.00	4,300.00

Urbanizmi	103,000.00	22,450.00	23,450.00	23,800.00
Taksa komunale për leje ndërtimi	35,000.00	200.00	200.00	200.00
Taksa tjera administrative	4,000.00	4,200.00	4,250.00	4,300.00
Taksa për demolim	2,000.00	550.00	600.00	800.00
Taksa për legalizimin e objekteve	38,000.00	-	-	-
Shfrytëzimin e pronës publike	24,000.00	-	-	-
Inspektimi respektimi i planit urbanistik		17,500.00	18,400.00	18,500.00
Kadaster dhe Gjeodezia	70,000.00	71,250.00	71,500.00	71,800.00
Taksa për regjistrimin e trashëgimisë	27,000.00	23,250.00	23,400.00	23,600.00
Taksa tjera administrative	25,000.00	25,000.00	25,100.00	25,200.00
Taksa për matjen e tokës në terren	18,000.00	23,000.00	23,000.00	23,000.00
Sherbime Publike	160,800.00	63,300.00	64,400.00	64,934.00
Taksa për leje gërmime	1,800.00			
Taksa tjera administrative	1,000.00	800.00	1,500.00	1,600.00
Te hyrat nga shitja e mbeturinave	140,000.00	47,000.00	47,200.00	47,400.00
Shfrytëzimi i pronës publike	10,000.00	12,000.00	12,100.00	12,234.00
Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare	8,000.00	500.00	600.00	700.00
Qiraja nga objektet publike	-	3,000.00	3,000.00	3,000.00
Inspekcioni	6,000.00	2,000.00	2,300.00	2,550.00
Taksa tjera administrative	6,000.00	1,000.00	1,200.00	1,400.00
Gjobat nga inspektoriati	-	1,000.00	1,100.00	1,150.00
Bujqësia dhe zhvillimi rural	10,600.00	55,300.00	56,100.00	56,500.00
Taksa tjera administrative	1,200.00	800.00	850.00	900.00
Taksa -të hyrat nga pyjet	400.00	500.00	550.00	600.00
Shfrytëzimi i pronës publike (Qiraja e tokës bujqësore)	500.00	1,000.00	1,500.00	1,300.00
Participimet në Bujqësi	8,500.00	52,000.00	52,100.00	52,500.00
Taksa për nderimin e destinimit të shfrytëzimit të tokës	-	1,000.00	1,100.00	1,200.00
Arsimi dhe Shkencë	25,000.00	9,900.00	10,189.00	10,300.00
Participimet -qerdhja e fëmijëve	10,000.00	9,500.00	9,650.00	9,700.00
Taksa tjera administrative	-	200.00	289.00	300.00
Participim për arsim joformal	15,000.00	200.00	250.00	300.00
Shëndetësia dhe mirëqeniet sociale	50,000.00	41,000.00	41,100.00	41,200.00
Participimi nga shëndetësia	50,000.00	40,000.00	40,000.00	40,000.00
Taksa tjera administrative	-	1,000.00	1,100.00	1,200.00
Mbrojtje dhe siguri civile	98,600.00			
Gjobat në trafik	43,600.00	-	-	-
Gjobat në trafik nëpërmjet gjykatave	55,000.00	-	-	-

Komuna e Rahovecit vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 90 % të buxhetit total të komunës.

3.2.1 Donatorët e jashtëm (ndërkombëtarë)

Financimi nga donatorët e jashtëm dhe të brendshëm do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2020-2022 në shumë fusha si në arsim, infrastrukturë, menaxhimin e mbeturinave, ujërave të zeza etj.

3.2.2 Politikat e reja

Komuna e Rahovecit në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka iniciuar Qeveria Nationale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale.

Fillimisht, ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2020-2022, sugjerimit të Qeverisë së Kosovës janë që shuma e Grandit të Përgjithshëm të Komunave që aktualisht është dhjetë përqind (10%) e të hyrave totale të buxhetore të Qeverisë Qendrore, (duke përfshirë të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja) do të reduktohet në 8 %, në vitet e ardhshme. Projektionet e bëra për 2020 dhe 2022 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, nuk reflektojnë ende këtë politikë. Për komunën e Rahovecit kjo do të vazhdojë të jetë një risk që duhet trajtuar në të ardhmen dhe duke menduar strategjitë që duhet ndjekur me qëllim të mbulimit të asaj difference që do të shkaktonte ulja e nivelit të Grandit të Përgjithshëm, për komunën.

Së dyti, në rast se në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shtetërore të ndarjes së grandit të arsimit për komuna, ndarje kjo që pretendohet të bëhet në bazë të normës e jo të numrit të nxënësve, atëherë kjo do të ketë ndikim të dukshëm në buxhetin e Komunës, ulë grandin e arsimit, sidomos duhet pasqyruar se ky grand përbën pjesën më të madhe të buxhetit komunal. Komuna nuk ka informatat e nevojshme për të bërë analizën e im paktit të kësaj politike.

Së treti, sa i përket politikave të reja ose atyre të paralajmëruara nga niveli qendror, me ndikim në komunën e Rahovecit, është edhe politika që do të zgjidhet nga viti 2020 e tutje, në lidhje me trajtimin e mirëqenies sociale si kompetencë e decentralizuar në komunat e Kosovës. Komuna e Rahovecit aktualisht nuk posedon informatat e nevojshme në lidhje me mënyrën e ndarjes buxhetore që do të bëhet për financimin kësaj fushe, ndryshe nga ajo që është aktualisht, ndonëse ka paralajmërim nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave sa i përket këtyre politikave.

Së katërti, komuna e Rahovecit ka mirëpritur deklaratimet e Qeverisë Nationale, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përveç pagave, të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Grandi i Përgjithshëm si shtesë, përveç se nga të hyrat vetanake komunale.

Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të Komunës, apo të hyrave vetanake, sërish Qeveria Nationale ka shtyrë drejt politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes, eventualisht eliminimit të atyre taksave e ngarkesave komunale që rëndojnë ambientin biznesor

komunal. Edhe në të ardhmen barra kryesore në realizimin e hyrave vetanake bie mbi tatimin në pronë dhe në tatimin në tokë.

3.3 Tendanca e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2020-2022

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuara përmes Qarkores Buxhetore komunale 2020 komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2020, duke përfshirë kategorinë Paga dhe Mëditje. Si rezultat komuna e Rahovecit prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive të lejuara buxhetore:

Projeksionet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2020 do të paraqesim sipas kategorive ekonomike që aktualisht janë funksionale (figura 2)

• Pagat dhe mëditjet	8,644,220.00 €
• Mallrat dhe Shërbimet	1,594,330.00 €
• Shpenzimet Komunale	280,500.00 €
• Subvencionet dhe Transferet	311,000.00 €
• Shpenzimet Kapitale	3,905,770.00 €
TOTAL	14,735,820.00 €

3.3.1 Pagat dhe Mëditjet

Gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin 2019, kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet **13.98 %** si rezultat i ligjit të pagave, pagesën e stazhit të punës. Kjo kategori e shpenzimeve gjatë periudhës 2020-2022 pritet të rritet me një mesatare vjetore prej 4.7 % bazuar në KASH-in e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe mëditjeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore komunale, gjatë këtyre viteve, pritet të mbetet në nivel të përafërt **58.65 %**.

3.3.2 Mallrat dhe Shërbimet

Kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime (duke përfshirë komunalit), është rritje për **5.60 %** nga viti 2019 në vitin 2020, edhe pse kemi rritje të konsiderueshme të shpenzimeve të kësaj kategorie e cila kryesisht i atribuohet rritjes së shpenzimeve për pagesën e mbeturinave, për mirëmbajtjen e projekteve (të reja) kapitale të shkollave, pagesat për ndriçimet publike, shërbimet e varrimit, pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve komunale, punkteve shëndetësore, objekteve sportive etj), rritjes së nevojave për material shpenzues (lëndë djegëse dhe karburante në proporcion me zgjerimin sipërfaqeve të objekteve të reja). Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, gjatë këtyre 3 viteve të ardhshme pritet të jetë mesatarisht **12.72 %**.

3.3.3 Subvencionet

Në vitin 2020 komuna e Rahovecit do të ndajë subvencionet për bujqësi, shëndetësi, arsim, kulturë, rini dhe sport. Nga viti 2018 shpenzimet për shërbimet e varrimit janë tërhequr nga kjo kategori, por nga kategoria e subvencioneve do të paguhen bursat për studentë. Pjesëmarrja e subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore gjatë viteve 2020-2022 mesatarisht do të jetë **2.11 %**.

3.3.4 Investimet Kapitale

